



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Komunikim dhe
Marrëdhënie me Publikun”**

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



Dr. Diana Kalaja

Prof.As.dr. Ramadan Çipuri

Janar/2025

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS,Nr. 238, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Me kohë të plotë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët	
15	Diplomë e dyfishtë	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli gjashtë 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2021-2022: 19 PAE/1 PAK V.a 2022-2023: 19 PAE/1 PAK V.a 2023-2024: 19 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2021-2022: 17 studentë V.a 2022-2023: 8 studentë V.a 2023-2024:11 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun,” i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, përfaqëson një iniciativë në përputhje me kërkesat e arsimit të lartë dhe nevojat e tregut të punës. Licensimi i këtij programi me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 238, datë 19.07.2021, e vërteton angazhimin institucional për të ofruar një kurrikulë të standardizuar dhe cilësore.

Programi ka një ngarkesë mësimore prej 180 kredite (ECTS) dhe zgjat tre vite akademike, duke ofruar një balancim të mirë midis teorisë dhe praktikës. Objektivi kryesor i këtij programi është pajisja e studentëve me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në fushën e komunikimit, si dhe në disiplinat humane që e mbështesin atë. Kjo përgatitje është në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri dhe përtej saj, duke i hapur mundësi karriere në sektorin publik, privat dhe jofitimprurës.

Përveç përgatitjes së studentëve për tregun e punës, programi ofron gjithashtu mundësi për zhvillimin e studimeve të avancuara në ciklet e mëtejshme, duke përfshirë Masterin e Shkencave dhe Masterin Profesional. Kjo siguron një rrugë të qartë për studentët që dëshirojnë të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushat përkatëse.

Programi i studimit në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është një iniciativë e vlefshme që promovon një mësimdhënie cilësore, përgatit studentët për sfidat e tregut të punës dhe kontribuon në zhvillimin e një force punëtore të kualifikuar në sektorët e komunikimit dhe marrëdhënieve publike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për të realizuar një analizë të plotë dhe të saktë të programit të studimit Bachelor në “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun,” fillimisht u njoh me evidencat e paraqitura nga institucioni. Këto dokumente përfshinin planin mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloret e programit, informacione mbi strukturat mbështetëse, si edhe një numër të lartë evidencash, të cilat ofronin një pamje të qartë mbi organizimin dhe menaxhimin e programit.

Në datat 4 dhe 5 nëntor 2024, grupi zhvilloi një seri takimesh në institucion, të cilat ishin planifikuar paraprakisht sipas një agjende të detajuar. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje. Dr. Diana Kalaja , Prof.asoc.dr. Ramadan Çipuri. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Gjatë këtyre takimeve, anëtarët e grupit patën mundësinë të dialogonin me personelin akademik, drejtuesit dhe studentët, si edhe përfaqësues të zyrave të ndryshme brenda institucionit, duke mbledhur informacione të rëndësishme rreth praktikave të mësimdhënies, metodologjive të vlerësimit dhe kriterëve të parashikuara në standardet e formatit të raportit për vlerësimin e jashtëm. Këto takime ofruan një perspektivë të drejtpërdrejtë mbi përvojat dhe sfidat që përballen studentët dhe pedagogët, si dhe mbi eficiencën e metodave të mësimdhënies të aplikuara.

Pas përfundimit të takimeve, grupi analizoi me kujdes evidencat e mbledhura dhe informacionet e grumbulluara, duke i referuar ato për të formuluar një raport të detajuar. Ky raport përfshin një analizë të gjitha standardeve dhe kriterëve të vlerësimit të programit, duke u siguruar që secili aspekt të jetë vlerësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Një element kyç i raportit është analiza SWOT e programit, e cila identifikon pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që ndërlidhen me zbatimin e tij. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ndihmon në krijimin e një panorame të qartë mbi performancën e programit dhe ofron një bazë të fortë për rekomandimet për përmirësim, duke u fokusuar në strategjitë që do të rrisin cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen profesionale të studentëve.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/ 68 Prot, datë 23.12.2024. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, njofton në ASCAL më datë 10.01.2025, me anë të shkresës me Nr.1912/1 Prot, datë 10.01.2025 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtar si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” (KMP) i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane (FDSHH), është i dizajnuar në përputhje me interesat kombëtare të vendit. Ai kontribuon në formimin e specialistëve në këtë fushë, si dhe në zhvillimin e qytetarëve të përgjegjshëm, që janë kontribues aktivë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Programi mbështetet në Statutin e UMSH, ku theksohet qartë angazhimi i institucionit për të ruajtur dhe mbrojtur interesat kombëtare. Për më tepër, UMSH e rregullon dhe strukturon këtë program në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, duke siguruar një kuadër të qartë për ofrimin e kualifikimeve të nevojshme. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH, Kreu I, Neni 4, pika 2 (e)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit KMP është hartuar në përputhje të plotë me vizionin dhe misionin e UMSH-së, siç e përcakton Plani Strategjik i Zhvillimit të institucionit (<i>Evidenca 4</i>). Ky program fokusohet në transmetimin e njohurive teorike dhe praktike, duke përgatitur studentët si drejtues të marrëdhënieve me publikun dhe specialistë komunikimi. Kjo është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në këtë fushë, e cila identifikon nevojat e bizneseve private dhe administratës publike, duke i dhënë prioritet përgatitjes profesionale të studentëve (<i>Evidenca 5</i>). Kështu, programi kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe në përmbushjen e kërkesave të tregut të punës. <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor KMP</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe	Programi i studimit KMP është hartuar në përputhje dhe zbatim të strategjisë për zhvillimin e vendit, si dhe të statutit dhe rregullores së organizimit të UMSH-së. Kërkesat e statutit dhe objektivat e strategjisë janë reflektuar në mënyrën e organizimit dhe në hartimin e planeve mësimore që përfshihen

Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	në këtë program (<i>Evidenca 1, Evidenca 3, dhe Evidenca 4</i>). Për më tepër, strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në këtë fushë ndihmon në alokimin e burimeve dhe përgatitjen e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës (<i>Evidenca 5</i>). Kështu, programi siguron një strukturë të qartë dhe të qëndrueshme për arsimimin e cilësisë.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Njësia bazë përgjegjëse për programin KMP, Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave, përbëhet nga pedagogë të kualifikuar dhe me kontratë, të cilët janë angazhuar në këtë program që nga themelimi i tij. Kjo strukturë ka për qëllim konsolidimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së programit. Në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane, ndodhet një kombinim i stafit elitare dhe pedagogëve të gjeneratës së re, të gjithë me përvojë në mësimdhënie, çka mundëson shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira. Personeli akademik dhe mbështetës për programin e studimit për vitin akademik aktual përbëhet kryesisht nga personel akademik efektiv (PAE) dhe një numër të vogël pedagogësh me kontratë (PAK). Ky program përfiton nga kontributi i një numri të konsiderueshëm pedagogësh, të cilët sjellin ekspertizë në fushat përkatëse, duke garantuar një nivel të lartë shkencor në hartimin e programit, syllabuseve dhe metodave të mësimdhënies. Lëndët që ofrohen në këtë program janë të organizuara në forma bazë, karakterizues, integruar dhe me zgjedhje, etj., në përputhje me parashikimet ligjore, duke siguruar një strukturë të plotë për formimin e studentëve (<i>Evidenca 6, Evidenca 7, Evidenca 8, dhe Evidenca 71</i>). <i>Evidenca 6. Plani mësimor KMP</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane.</i> <i>Evidenca 71. Tabela përmbledhëse excel</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë,	Programi "Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun" është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Ky program është krijuar për të adresuar nevojat e shoqërisë dhe për t'u përshtatur me standardet ndërkombëtare të edukimit, duke siguruar një formim të kualifikuar për specialistët në fushën e komunikimit. Për më tepër, programi i përmbush kërkesat e kornizës

përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	europiane dhe shqiptare të kualifikimit (AQF), duke garantuar cilësi dhe relevancë në tregun e punës. Kjo e bën atë një kontribues të rëndësishëm në zhvillimin profesional dhe akademik.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se ky program është ndërtuar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, duke respektuar interesat kombëtare, standardet ligjore dhe strategjitë zhvillimore të Universitetit. Për më tepër, organizimi i lëndëve dhe struktura akademike përmbushin kërkesat e kornizës evropiane dhe shqiptare të kualifikimit, duke garantuar cilësi dhe një formim të qëndrueshëm për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni siguron një organizim të qartë dhe efikas për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. Çdo njësi dhe personel ka detyra dhe kompetenca të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit, si statuti dhe rregulloret përkatëse. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave, si njësi kryesore, garanton ecurinë e procesit mësimor dhe mbikëqyr cilësinë e syllabuseve dhe zbatimin e tyre. Bashkëpunimi me NJBSCZHK siguron një monitorim të vazhdueshëm të cilësisë, ndërsa koordinimi me njësitë e tjera ndihmon në krijimin e kushteve optimale për realizimin e programit mësimor. Njësia gjithashtu merr masa për të garantuar që personeli akademik të realizojë orët mësimore sipas planit dhe kalendarit akademik, duke kontribuar kështu në një proces arsimor të suksesshëm dhe efektiv. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor KMP</i>

	<i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEFKF</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK, Neni 4</i> <i>Evidenca 12. Procesverbal mbledhje DEFKF</i> <i>Evidenca 71. Tabela përmbledhëse excel</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Objektivat e programit të studimit promovojnë bashkëpunimin e UMSH me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit. UMSH ka krijuar marrëveshje me universitete të njohura shqiptare dhe të huaja, si dhe ka zhvilluar lidhje me aktorët e biznesit dhe institucione publike e private. Këto marrëdhënie ofrojnë mundësi për staf dhe studentë për të marrë pjesë në mobilitete, trajnime, aktivitete kërkimore dhe praktikë mësimore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e tyre profesional dhe në përmirësimin e mundësive të punësimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo qasje rrit cilësinë e procesit mësimor dhe formues për studentët. <i>Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UMSH ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione publike dhe private, si dhe me organizata joqeveritare. Si anëtar i EMUNI, UMSH përfaqëson një pikë kyçe në arsimin e lartë në rajonin Euro-Mesdhetar. Duke ndjekur një vizion strategjik të ndërkombëtarizimit, institucioni ka vendosur marrëveshje me universitete brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilat përforcojnë traditën e tij të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunuese. Këto marrëveshje ofrojnë mundësi për staf dhe studentë për të marrë pjesë në mobilitete, trajnime dhe projekte kërkimore, duke rritur kështu përvojën e tyre profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave, si njësia përgjegjëse për programin, harton rregullisht raporte analitike përfitimesh nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, si në vend ashtu edhe jashtë tij. Këto raporte lejojnë një vlerësim të vazhdueshëm të produkteve dhe përfitimeve të marrëveshjeve, duke ndihmuar në vendimmarrjen për rinovimin apo përmirësimin e tyre. Pavarësisht numrit të marrëveshjeve në fuqi, institucioni vazhdon të kërkojë bashkëpunëtorë dhe partnerë të rinj për të rritur cilësinë dhe ndikimin e programit të studimit. Kjo qasje garanton një përmirësim

të programit të studimit.	të vazhdueshëm dhe një rritje të efikasitetit në arritjen e objektivave akademike. Ndërkohë, nga vizita në institucion u vu re se Universiteti analizon në mënyrë të vazhduar efektshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke siguruar mbarrëvajtjen e tyre. Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH			
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush plotësisht kriteret e këtij standardi, duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucionesh, kompanish dhe aktorësh të biznesit, si vendas ashtu edhe të huaj, të cilat mbështesin realizimin e programit të studimit. Këto bashkëpunime kontribuojnë në aftësimin profesional të studentëve, kërkimin shkencor dhe mundësitë për mobilitet, duke përmirësuar përvojën akademike dhe praktike të studentëve dhe duke e orientuar atë drejt kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit	Programi i Studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” është strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht VKM Nr. 41 dhe Vendimin Nr. 879, dhe organizohet në lëndë e module të vlerësuara sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program realizohet në një cikël trevjeçar, me 60 kredite ECTS për çdo vit akademik, duke e bërë totalin 180 kredite. Plani mësimor përfshin të gjitha detajet e nevojshme, duke përfshirë emërtimin e lëndëve, semestrin e zhvillimit, ngarkesën mësimore dhe mënyrën e vlerësimit. Çdo kredit ECTS lënde është

dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	e vlerësuar sipas raportit 1/25, duke garantuar një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore midis semestrave. Kjo strukturë e qartë siguron që studenti të ketë një përvojë arsimore të plotë dhe cilësore, duke e përgatitur atë për kërkesat e tregut dhe sfidat profesionale. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH, neni 63</i> <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky programi studimi është projektuar për të zhvilluar shprehje të veçanta në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi kritike të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse. Ky program, në përputhje me strategjinë e UMSH, synon të përgatisë studentët për tregun e punës dhe t'i bëjë ata qytetarë aktivë. Përmes një kombinimi të teorive të komunikimit, praktikës laboratorike dhe praktikave në kompani partnere, studentët zhvillojnë aftësi të nevojshme për të kontribuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi i përgatit ata të kryejnë studime tregu, të hartojnë strategji komunikimi, dhe të përdorin teknika efektive në marrëdhëniet me publikun dhe marketing. Studentët gjithashtu mësojnë të formulojnë deklarata për media dhe të menaxhojnë departamente të marketingut dhe marrëdhënieve me publikun, duke i përgatitur kështu ata për sfidat e tregut të punës dhe nevojat e shoqërisë moderne. Kjo qasje e integruar siguron një formim të plotë dhe cilësor, duke kontribuar në zhvillimin e individëve të aftë dhe profesionalë. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit KMP</i> <i>Evidenca 6. Plani mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e tregut dhe udhëzimet e ASCAL për ruajtjen e standardeve dhe cilësisë. Kohëzgjatja e studimeve është tre vite akademike, gjatë të cilave studentët përfitojnë 180 kredite. Struktura e programit përfshin një ndarje të qartë të lëndëve në kategori të ndryshme, ku lëndët bazë zënë 19% për formimin e përgjithshëm, lëndët karakterizuese 51% për formimin specifik, ndërsa lëndët ndërdisiplinore dhe plotësuese zënë përkatësisht 14% dhe 11% të programit. Provimi përmbyllës përfaqëson 4% të tij.

	Ngarkesa për secilën kategori është përcaktuar sipas treguesve të ASCAL, duke siguruar një rrjedhë logjike në zhvillimin e lëndëve. Kjo ndarje e qartë garanton një formim të plotë dhe të balancuar, duke e përgatitur studentin për sfidat e profesionit dhe tregut të punës. Nga analiza e stafit mësimdhënës për vitin mësimor aktual, rezultojnë se: ▪ Lëndët Bazë (A) 34 ECTS, ose 19% ▪ Lëndët Karakterizuese B 92 ECTS, ose 51% ▪ Lëndët Ndërdisciplinare/ Integruuese (C) 26 ECTS, ose 14% ▪ Lëndët Plotësuese formuese (D) 20 ECTS, ose 11% ▪ Punimi i diplomës/ provimi 8 ECTS, ose 4% Vetëm lëndët “Hyrje në menaxhim”, Veprimtari Formuese A me 4 ECTS, që zhvillohet në vitin e parë dhe “Negociatat dhe zgjidhja e konflikteve” Veprimtari Formuese B, me 6 ECTS, që zhvillohet në vitin e tretë, jepen nga staf akademik me kontratë, PAK. <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Në planin mësimor, janë të përfshira 6 ECTS për realizimin e praktikës profesionale dhe 8 ECTS për provimin e diplomës. Gjithashtu, lëndët dhe modulet që fokusohen në aftësimin e studentëve në kërkimin shkencor janë të dokumentuara, duke siguruar një përgatitje të plotë për përfundimin e programit. Përfundimi i studimeve nënkupton realizimin e provimit të formimit, i cili regjistrohet me notën përkatëse, duke garantuar kështu një vlerësim të saktë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët. Kjo strukturë e qartë e krediteve siguron një përgatitje të mirë për sfidat profesionale dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Evidenca 6. Plani mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status	NA

të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi Bachelor në “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun: përmbush me sukses këtë kriter, pasi përmbajtja e tij është ndërtuar duke pasur parasysh harmonizimin me programet e ngjashme në të njëjtën fushë dhe cikël studimi. Struktura e lëndëve dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet janë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar që së paku 70% e përmbajtjes të jetë e ngjashme. Kjo siguron një kurrikul të harmonizuar dhe të krahasueshme me programet e tjera të akredituara në Komunikim dhe Marrëdhënie Publike.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” është hartuar në përputhje me VKM dhe udhëzimet e tjera përkatëse për kodifikimin e programeve të studimit. Kodi i këtij programi është 63BA0388S, si edhe më tej është vijuar me kodifikimin e lëndëve të tij.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit përmbush plotësisht Standardin II.1, duke përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për organizimin e tij në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare në fuqi.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane (FDSHH) përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të tij. Si njësi kryesore, FDSHH bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe shkencore me njësitë bazë dhe ofron një gamë të gjerë programesh studimi, të gjitha të licensuara dhe nën procesin e vlerësimit periodik.				
	Departamenti Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr	1		1	
	Prof.As	1		1	
	Dr	4		4	
	MSc	6		6	
	Total	12	0	12	0
	Ky fakultet është organizuar në katër departamente, përfshirë: Departamentin e Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave; Departamenti i Sociologjisë dhe Psikologjisë; Departamenti i së Drejtës;Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave është përgjegjës për programin “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun”. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe koordinon veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fushën e komunikimit dhe disiplina të lidhura.				
	Në lidhje me numrin e personelit akademik, në raport të drejtë me njësitë bazë në varësi të tij, ky fakultet e përmbush këtë kriter. Referuar evidencave të dokumentuara nga institucioni, për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-24 në FDSHH, respektivisht janë angazhuar gjithsej 50 PAE dhe 17 PAK, si edhe 47 PAE dhe 17 PAK, duke respektuar parashikimet ligjore për të gjitha njësitë bazë.				
	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane për dy vite akademike ka në përbërjen e tij:				
	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	
Prof.Dr	3	2	4		
Prof.As.Dr	6	1	5	2	

	Dr	28	7	26	9
	MSc	13	7	12	6
	Total	50	17	47	17
	Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi përmbush kriteret ligjore në përbërjen e stafit akademik, me 12 anëtarë me kohë të plotë, përfshirë 7 me tituj akademik e grada shkencore dhe 5 me titull MSc. Gjithashtu, departamenti angazhon edhe 1 punonjës me kontratë. Kjo strukturë akademike është e rëndësishme për ofrimin e një arsimit cilësor dhe për avancimin e kërkimit shkencor në fushën e komunikimit. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Kreu II, Neni 3; Kreu VI, Neni 26, Neni 27,</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEFKF</i>				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Referuar evidencave të dokumentuara nga institucioni, por edhe vizitës që zhvilluam në mjediset e tij, konstatuam se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane (FDSHH) përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ për të mbështetur realizimin e praktikave mësimore dhe administratave të programit. Personeli ndihmës akademik ofron shërbime këshillimi për studentët dhe merr përsipër detyra administrative brenda Departamentit të Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave (DEKFK). Këto aktivitete janë të dizajnuara për të siguruar kushte optimale për realizimin e objektivave të programit, duke kontribuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit. Është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse natyra e programit nuk kërkon praktikë laboratorike apo klinike, angazhimi i personelit ndihmës mbetet i rëndësishëm për garantimin e një mjedisi të suksesshëm mësimor. Kjo siguron që studentët të kenë mbështetje të vazhdueshme për të përmbushur kërkesat akademike dhe për të arritur objektivat e tyre.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës	FDSHH ka caktuar një koordinator për programin e studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun”, i cili ka përgjegjësinë për monitorimin e ecurisë dhe zhvillimit të programit, duke u siguruar që ai përputhet me objektivat e parashikuara. Ky koordinator punon në bashkëpunim me sekretarinë e fakultetit dhe ndihmon dekanin në menaxhimin e çështjeve të fakultetit. Ai gjithashtu nxit bashkëpunimin midis departamenteve dhe kontribuon në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me planin e punës të njësisë kryesore.				

për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, në kreun IV, nenin 19, përcakton qartë rolin dhe detyrat e koordinators, duke garantuar kështu një strukturë të qartë menaxhimi dhe koordinimi për programet e studimit. Kjo qasje është thelbësore për sigurimin e cilësisë dhe suksesin e programit, duke mundësuar një monitorim efektiv dhe adaptim të vazhdueshëm në përputhje me nevojat e studentëve dhe tregut. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Kreu IV, Neni 19</i>			
Konkluzione	<i>Referuar evidencava të depozituara nga institucioni dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitës në mjediset e tij, GVJ vlerëson se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për këtë program studimi i përmbushin plotësisht kriteret e këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FDSHH dhe DEKFK tregojnë një organizim të mirë të programit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”. Dokumentacioni i paraqitur, përfshirë planin mësimor dhe syllabuset, ofron informacion të qartë mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit. Në përgjithësi, njësitë përgjegjëse kanë krijuar një bazë solide për zhvillimin e programit. <i>Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor KMP Kreu II.</i> <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët	Plani mësimor i këtij programi tregon një përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai ofron informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, duke përfshirë emërtimin e lëndës, semestrin e zhvillimit dhe ngarkesën mësimore të orëve në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe kreditet në ECTS.

në auditor/jashtë auditorit.	Programi përfshin gjithsej 180 ECTS dhe pasqyron një ngarkesë mësimore të qartë për leksione, seminare dhe praktika. Ndarja e lëndëve është bërë me një strukturë logjike, duke siguruar koherencë në përbajtje dhe lidhje të forta mes moduleve. Metodat e vlerësimit janë të qarta, duke përfshirë kontrollin e dijeve kryesisht përmes provimeve, që ndihmon në garantimin e cilësisë dhe në përgatitjen e studentëve për sfidat e profesionit. Kështu, plani mësimor ofron një bazë të fortë për procesin mësimor dhe siguron që studentët të kenë një përvojë të plotë dhe të integruar në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. UMSH ndjek një politikë të qartë për pranimin e studentëve në ciklin e parë, duke përfshirë studentë shqiptarë dhe ata nga vende të tjera shqipfolëse, të cilët duhet të zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme. Procedurat e pranimit janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit dhe publikohen në të gjitha mjetet e informimit. Një komision i veçantë pedagogësh merr përsipër procesin e pranimit, duke u bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria përkatëse dhe kritere të veçanta të institucionit. Programi gjithashtu lejon transferimin e studimeve nga/në programe të tjera, me ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedurat e transferimeve janë të përcaktuara në aktet rregullatore dhe shprehen në një udhëzues të veçantë, duke garantuar transparencë dhe qartësi për studentët. Në përmbledhje, informacioni i ofruar është i detajuar dhe i organizuar mirë, duke siguruar që studentët të kenë akses të lehtë në kriteret dhe procedurat për pranimin dhe transferimin e studimeve. <i>Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor KMP Kreu III</i> <i>Evidenca 15. Broshura e programeve Bachelor</i>

Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Institucioni ka dokumentuar informacion të detajuar për syllabuset e lëndëve, që janë pjesë integrale e planit mësimor. Elementët e përfshirë në këto syllabuse përputhen me aktet ligjore e nënligjore, duke theksuar përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore dhe objektivat e secilës lëndë. Çdo syllabus ofron një strukturë të qartë, ku janë të detajuara temat dhe çështjet kryesore, së bashku me literaturën bazë dhe atë të rekomanduar. Kjo qasje siguron që studentët të kenë akses në informacionin e nevojshëm për përgatitjen e tyre akademike. Format e mësimdhënies dhe metodat e kontrollit të njohurive janë gjithashtu të detajuara në syllabuse, duke ofruar transparencë dhe orientim për studentët në lidhje me procesin e vlerësimit. Kjo ndihmon në krijimin e një ambienti mësimor të qartë dhe të strukturuar. <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është subjekt i një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi. Çdo vit akademik, DEKFK kryen një analizë të detajuar të syllabuseve të të gjitha lëndëve përpara fillimit të procesit mësimor, duke siguruar që çdo ndryshim të nevojshëm të merret në konsideratë në kohë. Gjatë takimit me anëtarët e personelit akademik u pohua se syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka së paku gradën “Doktor i Shkencave”. Ky i fundit merr për bazë sygjerimet e bëra nga studentët përmes pyetësorëve të vlerësimit, si edhe dinamikat që shoqërojnë fushën përkatëse, duke i reflektuar në përmbajtjen e syllabusit. Ndërkohë, analiza përfshin vlerësimin e përputhshmërisë së syllabusit me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, dhe kërkesat e tregut të punës. Elementet kyçe të rishikimit përfshijnë rifreskimin e literaturës, përshtatjen e temave teorike me aplikimin praktik, si dhe adaptimin e metodave të vlerësimit. Këto veprime kontribuojnë në krijimin e një programi të ngjashëm me nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>

Konkluzione	<i>Po, nga sa më sipër, kostatojmë se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Mbështetur në evidencat e institucionit, por edhe në vizitat që zhvilluam në institucion, vlerësojmë se programi i studimit ofron një strukturë të mirëpërcaktuar që thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve, duke i përgatitur ata për studime të mëtejshme dhe/ose për tregun e punës. Kombinimi i lëndëve është i ndarë në mënyrë strategjike në të gjithë semestrat, duke u përshtatur si me objektivat e programit, ashtu edhe me kërkesat e tregut. Kjo qasje garanton që studentët të fitojnë njohuri relevante dhe praktike, të cilat janë të nevojshme për të filluar një karrierë profesionale ose akademike. Praktika profesionale, e cila realizohet në fund të studimeve, ka një rol thelbësor në këtë përgatitje. Kjo është e evidentuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve, duke treguar se programi fokusohet në aplikimin praktik të njohurive. Në përgjithësi, struktura dhe përmbajtja e programit janë të dizajnuara për të siguruar një arsimim cilësor që i përgatit studentët për sfidat e botës reale. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 16. Dosja e praktikës Bachelor</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në	Referuar planit mësimor dhe përmbajtjes së syllabuseve, vihet re se ka një shpërndarje të mirëorganizuar të lëndëve dhe moduleve që mbështet arritjen e objektiveve formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënës. Shpërndarja e lëndëve është e strukturuar në mënyrë që

kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	të kalojë natyrshëm nga formimi i përgjithshëm në formimin karakterizues, duke përfshirë gjithashtu lëndë integruese e plotësuese. Ngarkesa mësimore është organizuar në një periudhë 15-javore për secilin semestër, çka lehtëson arritjen e rezultateve të pritshme dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Kjo strukturë e shpërndarjes, me lëndët e formimit të përgjithshëm në vitin e parë dhe lëndët karakterizuese në vitin e dytë dhe të tretë, ofron mundësinë për një zhvillim të vazhdueshëm të njohurive profesionale. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është e organizuar në përputhje me profilin e studimit dhe është e përafërt me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Plani mësimor ofron informacione të detajuara për emërtimin e lëndëve, numrin e krediteve, semestrin e zhvillimit dhe raportin e orëve të leksioneve dhe seminareve. Çdo modul përmban detyrime të qarta si seminare, projekte kursi dhe detyra kontrolli, duke përfshirë dhe mënyrat e vlerësimit (provime me shkrim, me gojë, etj.). Kjo qasje siguron një raport të mirë midis teorisë dhe praktikës, duke e përgatitur studentin për sfidat e botës reale. Programi është i harmonizuar me ofertat e institucioneve të tjera në vend dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që studentët të kenë një përvojë edukative cilësore dhe të përgatitur për tregun e punës. Kjo vërtetohet sa përmes planit mësimor, po aq edhe përmbajtjes së syllabuseve, të cilët tregojnë për një praktikë të kënaqshme në përmbushje të këtij kriteri.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Mbështetur në mënyrën e organizimit të planit mësimor, përmbajtjes së syllabuseve, planit strategjik të këtij programi dhe disa akteve të tjera të brendshme, mund të themi se ky program studimi është i ndërtuar në mënyrë që të sigurojë një balancë të mirë midis formimit teorik dhe praktik. Kjo ndarje sipas veprimtarive formuese mbështet arritjen e objektivave formues dhe lehtëson transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve, si më poshtë: ▪ Lëndët Bazë (A) 34 ECTS, ose 19% ▪ Lëndët Karakterizuese B 92 ECTS, ose 51% ▪ Lëndët Ndërdisiplinare/ Integruese (C) 26 ECTS, ose 14% ▪ Lëndët Plotësuese formuese (D) 20 ECTS, ose 11%

	▪ Punimi i diplomës/ provimi 8 ECTS, ose 4% Vlerësimi i lëndëve me ECTS ofron mundësinë për krahasimin e njohurive mes programeve të ngjashme, duke lehtësuar kështu transferimin e krediteve. Ky sistem ndihmon studentët të mbajnë fleksibilitet në zgjedhjet e tyre akademike, duke u siguruar gjithashtu që ata janë të përgatitur për kërkesat e tregut të punës. Kombinimi i njohurive teorike me praktikën e zhvilluar në terren i jep studentëve kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për t'u integruar me sukses në pozita pune të kërkuara. Kjo qasje jo vetëm që rrit punësueshmërinë e studentëve, por gjithashtu i përgatit ata për sfidat e karrierave në fushën e komunikimit. <i>Evidenca Plani strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pavarësisht informacioneve të siguruar gjatë takimeve që u zhvilluan në institucion dhe takimit me drejtuesit e njësisë bazë, por edhe me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, vlerësojmë se edhe pse bëhet fjalë për një program të ri, evidentohet një vëmendje e veçantë për reflektimin e ndryshimeve në informacionet teorike dhe aplikative, si dhe për tendencat e zhvillimit në fushën e komunikimit. Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse për çdo lëndë përditësohen vazhdimisht, duke u mbështetur në botimet më të fundit dhe relevante, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaja. Kjo qasje siguron që studentët të kenë qasje në materiale të reja dhe cilësore, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e kompetencave të tyre. Përditësimi i syllabuseve dhe rishikimi i tyre me fokus në literaturën më të fundit ndihmon në ruajtjen e cilësisë së programit dhe në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës. Ky përkushtim për inovacion dhe adaptim reflekton një strategji të fortë për arsimim të kualifikuar dhe praktik. <i>Evidenca 4. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit	Përmbajtja e programit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Njësitë bazë dhe kryesore kanë

garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	implementuar instrumenta të diversifikuar për të maksimizuar absorbimin e njohurive nga studentët. Programi përmban elementët e nevojshëm për një edukim cilësor, duke bashkuar teorinë me praktikën në lëndët e formimit të përgjithshëm dhe ato të specialitetit. Praktikat e vendosura janë të dizajnuara me qëllim që të profilizojnë studentët para diplomimit, duke ofruar përvojë të rëndësishme në terren. Kjo qasje integruese siguron që studentët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre, duke rritur vlerën e diplomës dhe përgatitur ata për sfidat e tregut të punës.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Po, konstatojmë se përmbajtja e programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është e strukturuar për të mundësuar vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve, duke përmbushur pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Njësia bazë dhe njësia kryesore mbajnë kontakte të rregullta me tregun e punës përmes lektorëve të ftuar dhe marrëveshjeve me institucione shtetërore dhe joshtetërore. <i>Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 72. Shembull lektor i ftuar nga Departamenti, A. Krasta</i> https://ëëë.facebook.com/keshillistudentor.umsh.9			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit në institucion është në përputhje të plotë me kërkesat e standardit, duke reflektuar objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe rezultatet e të nxënësve dhe mundësitë për vazhdimin e studimeve. Evidencat institucionale dhe vëzhgimet gjatë vizitës së realizuar konfirmojnë se programet synojnë zhvillimin e kompetencave që përputhen me kërkesat e tregut të punës, duke garantuar një arsim cilësor dhe të orientuar drejt përgatitjes profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”, njësitë përgjegjëse tregojnë një angazhim të qartë për të konsultuar dhe përfshirë propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private lejojnë UMSH-në të mbajë kontakte të rregullta dhe të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës, duke identifikuar kompetencat dhe njohuritë e kërkuara. Këto informacione mblidhen përmes takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me partnerët, përfshirë kompani dhe institucione të pushtetit qendror dhe lokal, ku studentët kryejnë praktikatat e tyre. Kjo qasje e integruar dhe e vazhdueshme përmbush nevojat e tregut dhe siguron që programi të jetë në përputhje me zhvillimet e fundit në fushë, duke rritur kështu cilësinë e edukimit dhe përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 20. Analiza e tregut të punës</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni tregon një angazhim të dukshëm për të përfshirë studentët dhe strukturat e tyre në proceset e përmirësimit të programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”. Njësia e Cilësisë (NJSBCZHK) dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës organizojnë fokus grupe për të mbledhur vlerësimet dhe opinionet e studentëve, duke i inkurajuar ata të kontribuojnë në diskutime të rëndësishme për zhvillimin e programit. Kjo qasje promovon një kulturë të hapur komunikimi dhe bashkëpunimi midis studentëve dhe administratës, duke përfshirë takime të rregullta me këshillin studentor dhe orë tutoriati akademik. Të dhënat e mbledhura nga këto aktivitete përcillen në njësitë përkatëse për të informuar vendimarrjen. Kjo mënyrë e angazhimit jo vetëm që siguron një përmirësim të vazhdueshëm të programit, por gjithashtu rrit ndjeshmërinë e studentëve ndaj procesit arsimor dhe i ndihmon ata të ndihen të përfshirë në zhvillimet që ndikojnë në karrierat e tyre të ardhshme. <i>Evidenca 18. Kalendari i takimeve të NJSBCZHK me këshillin studentor</i> <i>Evidenca 19. Shembull Focus Grupi me studentët e Komunikimit</i>

	https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit "Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun" demonstroi një angazhim të lartë për të përmirësuar dhe përditësuar përmbajtjen e programit në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën përkatëse. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ndërtuar marrëdhënie të forta bashkëpunimi me institucione publike dhe private, si dhe me rrjete profesionistësh, shoqata dhe urdhra profesionalë. Kjo qasje bashkëpunuese lejon njësitë përgjegjëse të integrojnë propozime dhe rekomandime nga ekspertë të jashtëm, duke siguruar që programi të mbetet relevant dhe i përditësuar. Kapacitetet didaktike dhe infrastrukturore të universitetit janë të përshtatshme për të përmbushur kërkesat dhe nevojat specifike që mund të lindin nga tregu, duke e pozicionuar programin në një nivel konkurrues. <i>Evidenca 21. Plani i aktiviteteve të departamentit</i> <i>Evidenca 73. Shembull Lektor i ftuar nga Departamenti. F. Hakorja.</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë demonstroi një angazhim të dukshëm për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve të ndryshëm, si dhe rrjeteve dhe organizmave përkatëse, në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Ky përkushtim garanton që programet të realizohen me sukses dhe të jenë në përputhje me objektivat e tyre formuese, duke siguruar një përshtatshmëri më të mirë me nevojat e tregut dhe zhvillimin e aftësive për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit ofron një gamë të gjerë formash për mësimdhënie, mësimnxënie dhe transmetim të dijeve. Këto forma përfshijnë leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi dhe provime. Pjesëmarrja e ekspertëve të ftuar nga fusha, si nga mediat dhe organizatat joqeveritare, është një element i rëndësishëm që pasuron përvojën e studentëve dhe ofron njohuri të avancuara. Kjo qasje ndihmon në ndërlidhjen e teorisë me praktikën, duke i përgatitur studentët për sfidat reale në tregun e punës. Këto forma mësimdhënieje kontribuojnë në krijimin e një ambienti edukativ dinamik dhe të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP 2023-2024</i> https://www.umsh.edu.al/d/446/shkrimtari-i-madh-ismail-kadare-viziton-universitetin-mesdhetar-te-shqiperise
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) angazhohet për të ofruar një mjedis arsimor të barabartë për të gjithë studentët, duke përfshirë ata me aftësi ndryshe. Personeli akademik është i përkushtuar për të përmbushur nevojat dhe larmitë e studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Në këtë kuadër, akademikët ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët, përfshirë orare konsultimesh shtesë dhe mundësi për të realizuar provime në përputhje me nevojat individuale. Komunikimi mes tutorëve dhe studentëve ndihmon në ndërtimin e një lidhjeje efektive, duke përfshirë takime të rregullta në auditor dhe platforma online si Classroom, ku mund të diskutohet për çdo aspekt të programit, siç janë detyrat, vlerësimet dhe leksionet.

	Evidenca 22. Shembull komunikimi në Classroom të tutorit akademik. Evidenca 24 Shembull komunikimi i një pedagogu në Classroom Evidenca 25. Shembull Email ZKSK https://umsh.edu.al/d/186/cikli-i-webinareve-te-universitetit-mesdhetar-te-shqiperise
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” (UMSH) mbështet vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke u siguruar që metodat e mësimdhënies përputhen me rezultatet e pritshme të të nxënit. UMSH angazhohet për të krijuar një mjedis arsimor të barabartë dhe për të ofruar mbështetje maksimale për studentët, përfshirë ata me aftësi ndryshe. Personeli akademik është i inkurajuar të përdorë metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe të adaptuar këto metoda sipas nevojave të studentëve. Kjo përfshin ofrimin e orareve konsultimesh shtesë dhe mundësinë për realizimin e provimeve sipas kërkesave individuale. Gjithashtu, pedagogët janë të angazhuar në përshtatjen e strategjive të mësimdhënies duke marrë parasysh diferencat në moshë dhe përvojat praktike të studentëve. Evidenca 24.Shembull komunikimi i një pedagogu në Classroom
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të	Referuar CV-ve të anërave të personelit akademik dhe publikimeve të tyre, vihet re se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” është i kualifikuar dhe me eksperiencë të gjerë, duke siguruar një mësimdhënie efektive dhe mbështetje për studentët. Pedagogët kanë grada shkencore dhe janë aktivë në kërkimin shkencor, çka kontribuon në kompetencën e tyre në shpjegimin e koncepteve dhe njohurive. Metodat e mësimdhënies janë të larmishme dhe përfshijnë një kombinim të teknikave tradicionale dhe inovative. Kjo qasje interaktive ndihmon në nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, duke i angazhuar ata në diskutime dhe duke i inkurajuar të marrin iniciativë. Gjatë takimit me studentët në institucion, u pohua se në leksione, përdoren shembuj aktualë nga praktika e mediave dhe institucionet publike, duke bërë mësimin më relevant dhe tërheqës.

respektit të ndërsjellë mes tyre.	E njëjta gjë u deklarua edhe për gjatë seminareve, ku pedagogët trajtojnë raste studimi dhe ushtrime, duke ofruar mbështetje për studentët që kanë paqartësi. Kjo metodologji ndihmon në identifikimin e vështirësive dhe nevojave për mbështetje të mëtejshme. Në përgjithësi, aplikimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies nxit autonominë, mësimin aktiv dhe kreativitetin te studentët, duke ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit dhe mbështetjes midis pedagogëve dhe studentëve. Evidenca 26. CV e stafit akademik të programit të studimit Komunikim dhe marrëdhënie me publikun
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit "Komunikim dhe marrëdhënie me publikun" në UMSH angazhohet aktivisht për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Kjo arrihet përmes një procesi të rregullt dhe sistematik, ku studentët luajnë një rol kyç. Vlerësimi periodik realizohet nëpërmjet strukturave si Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSBCZHK) dhe njësia bazë, të cilat mbledhin opinione dhe sugjerime nga studentët përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve. Këto mjete lejojnë një ndërlidhje të drejtpërdrejtë me studentët dhe një reflektim të mendimeve dhe nevojave të tyre. Rezultatet e monitorimit pasqyrohen në raporte të detajuara, të cilat i përcillen Rektoratit për të ndihmuar në marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve mësimore. Kjo qasje garanton që metodat e mësimdhënies të mbeten relevante dhe efektive, duke reflektuar realitetin dhe nevojat e studentëve. Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti Evidenca 19. Shembull raporti Focus Grup per komunikim dhe marredhenie me publikun Evidenca 19. Shembull raporti Focus Grup per komunikim dhe marredhenie me publikun
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,	Institucioni ka krijuar struktura dhe njësitë e nevojshme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) luan një rol kyç në këtë proces, duke zhvilluar aktivitete sipas një plani kalendarik të përvitshëm dhe duke bashkëpunuar ngushtë me njësitë bazë për monitorime të vazhdueshme.

koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Një prioritet i rëndësishëm është trajnimi i pedagogëve, i cili ndihmon në freskimin e njohurive mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UMSH. Këto trajnime adresohen për të përmirësuar performancën e individëve dhe të gjithë institucionit. Institucioni ka mundësuar trajnime të specializuara për personelin akademik, me fokus në metodikat e mësimdhënies dhe inovacionet në sektorët përkatës, përfshirë trajnime të veçanta për personelin e ri. Zhvillimi i metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies është një proces i vazhdueshëm, i mbështetur nga strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Përdorimi i metodave tradicionale të mësimdhënies kombinohet me forma të tjera, si ushtrimet praktike, punimet individuale dhe në grup, dhe diskutime të bazuara në materiale audiovizuale. Kjo qasje nxit mendimin kritik dhe angazhimin aktiv të studentëve. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 29. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 30. Plani i punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 31. Programi i trajnimeve 2022-2023</i> <i>Evidenca 32. Plani i monitorimit DFEKF</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë garanton një proces të të nxëniet që vendos studentin në qendër, duke ofruar aftësim profesional dhe shkencor përmes metodave dhe praktikave më të mira bashkëkohore. Kjo qasje siguron që studentët të arrijnë rezultatet e synuara të të nxëniet, duke zhvilluar kompetencat e tyre akademike dhe profesionale në përputhje me standardet më të larta arsimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen	Rregullorja e programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” përcakton qartë kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Ajo ofron detaje mbi mënyrat e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	vlerësimit, përfshirë testet me shkrim dhe vlerësimet gojore, të cilat mund të kombinohen sipas nevojave të lëndës. Nga takimi që u zhvillua me studentë në mjediset e institucionit, u vu re se ata e dinë se për të pasur të drejtën për të marrë pjesë në provim, duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për lëndën. Ky informacion është bërë publik dhe është i aksesueshëm përmes rregullores së programit, udhëzuesit për studentët dhe syllabus-it të çdo lënde. Të gjitha njësitë përgjegjëse për programin janë angazhuar për të siguruar që studentët të kenë njohuri të plota mbi këto kritere, duke i informuar verbalisht dhe në formë të shkruar.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lënde, personeli akademik informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që do të përvetësohen. Kjo ndodh gjatë orëve të para të procesit mësimor, ku titullari i lëndës shpjegon mjetet dhe instrumentet që do të përdoren për të vlerësuar përvetësimin e objektivave formues dhe kompetencave të programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”. Vlerësimi realizohet përmes një kombinimi të kontrollit të vazhdueshëm gjatë semestrit, provimit të ndërmjetëm dhe provimit përfundimtar, të gjitha të pasqyruara në syllabusin e çdo lënde. Pikat e vlerësimit shkojnë nga 0 në 100 dhe konvertohen në nota nga 4 deri në 10, duke siguruar kështu një sistem transparent dhe të kuptueshëm për studentët. Të gjitha këto informacione janë të disponueshme në syllabuset dhe udhëzuesin për studentët, duke e bërë procesin e vlerësimit të qartë dhe të lehtë për t’u ndjekur. <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 33. Udhëzues për studentët</i> <i>Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke lejuar studentët të demonstrojnë kompetencat e fituara. Aplikimi i formave tradicionale dhe alternative të vlerësimit reflekton metodat e ndryshme të mësimnxënies dhe mësimdhënies, duke e bërë vlerësimin një pjesë integrale të procesit mësimor. Përmbajtja e tezave të provimit përshtatet me natyrën e lëndës dhe synon të lehtësojë studentët në shprehjen e aftësive dhe

	dijeve të fituara. Kontrolli i njohurive nuk është një qëllim në vetvete, por një element i rëndësishëm i procesit të vlerësimit që mbështet si mësimnxënien ashtu edhe mësimdhënien. Qëllimi është përgatitja e studentëve për të kontribuar në organizatat dhe sektorët ku do të angazhohen, duke siguruar që ata të zhvillojnë kompetenca praktike dhe të aplikueshme në tregun e punës. <i>Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë dhe personeli akademik në programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun vlerësojnë dhe përmirësojnë format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Lektorët përdorin një metodologji të larmishme, e cila përfshin zhvillimin e leksioneve në auditor, si dhe metoda interaktive si diskutime, debate, simulime situatash, dhe punë në grupe të vogla. Këto qasje lejojnë studentët të ndajnë mendimet e tyre dhe të argumentojnë mbi temat e trajtuara. Metoda e interpretimit analitik dhe brainstorming-ut stimulojnë diskutimin dhe ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve të shpejta përmes analizës kritike. Aplikimi i metodave tradicionale dhe inovative synon të inkurajojë autonominë dhe mësimin aktiv, duke marrë parasysh mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me metodologjitë e përdorura. Kjo qasje kontribuon në zhvillimin e një mjedisi mësimor të pasur dhe dinamik. <i>Evidenca 74. Leksion i hapur ne departament</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga	Institucioni ofron metoda mësimdhënieje të shumëllojshme dhe fleksibile, të cilat janë të përshtatura me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Në programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, personeli akademik aplikon teknika mësimnxënieje që inkurajojnë autonominë e studentëve, duke siguruar gjithashtu udhëzimin dhe mbështetje nga ana e mësimdhënësve. Metodat vizuale dhe ato interaktive stimulojnë iniciativën dhe kreativitetin e studentëve. Testet e ndryshme, përfshirë ato me shkrim dhe me alternativa, janë të përshtatura për të përmbushur nevojat e studentëve me stil të ndryshëm të mësuarit. Të gjitha këto informacione janë të qarta në rregulloren e institucionit dhe në syllabuset përkatëse.

mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	UMSH siguron infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie, duke përfshirë pajisje teknologjike dhe ambiente të pajisura me kompjuterë, audio/video dhe internet, për të mbështetur procesin e mësimnxënies në mënyrë efektive. Kjo qasje promovon një mjedis mësimor dinamik dhe përfshirës.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, duke siguruar një proces vlerësimi të drejtë, të qëndrueshëm dhe të strukturuar. Zbatimi rigoroz i këtyre procedurave garanton që studentët të vlerësohen në mënyrë objektive dhe të ndershme, në përputhje me standardet akademike dhe profesionale të kërkuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3



Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin e studimit është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe efektive. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka identifikuar disa komponentë kyç, si detyrat e kontrollit dhe provimi përfundimtar, që realizohen në përputhje me aktet rregullative të UMSH. Këto aktivitete janë të shpërndara përgjatë semestrit, duke siguruar një monitorim të vazhdueshëm të përparimit të studentëve. Përdorimi i formave të ndryshme të vlerësimit, të përcaktuara në syllabus, ofron një qasje gjithëpërfshirëse që inkurajon angazhimin aktiv të studentëve. Transparenca në përcaktimin e përqindjeve për çdo komponent vlerësimi kontribuon në qartësinë e procesit dhe ndihmon studentët të kuptojnë rëndësinë e aktiviteteve të ndryshme. Evidencat e paraqitura, përfshirë syllabuset dhe format e kontrollit, demostrojnë angazhimin e institucionit për një proces të qëndrueshëm dhe cilësor vlerësimi. Rekomandoj vazhdimin e këtyre praktikave dhe shqyrtimin e mundësive për të diversifikuar më tej metodat e vlerësimit. <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 35. Formatet e kontrollit të njohurive të dijeve (teza, detyre kontrolli, ese)</i>

	Evidenca 36. Formati I shpalljes së temave të detyrave të kursit në javën e 6-të
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni implementon në disa raste sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit, duke adresuar në mënyrë efektive nevojat për transparencë dhe parandalim të abuzimeve. Përdorimi i platformave si Google Forms dhe Google Classroom, së bashku me trajnimet e ofruara për pedagogët, tregon një lloj angazhimi për integrimin e teknologjisë në procesin e vlerësimit. Formatet elektronike të testimit rrisin origjinalitetin e përgjigjeve dhe lehtësojnë monitorimin e rezultateve. Manuali i përdorimit të platformave elektronike ofron një bazë të fortë për pedagogët, duke siguruar një kuptim të qartë të procedurave dhe praktikave më të mira. Sugjerojmë vazhdimin e këtij drejtimi, duke eksploruar mundësi të tjera teknologjike për të përmirësuar akoma më tej procesin e vlerësimit dhe për të mbajtur një nivel të lartë transparence dhe integriteti akademik. Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformave elektronike
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës është i organizuar në përputhje me syllabusin dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar një strukturë të qartë dhe të standardizuar për testimin e njohurive të studentëve. Procedurat dhe afatet e përcaktuara në aktet rregullative të institucionit dhe në udhëzuesin për provimet ofrojnë një kornizë të fortë për menaxhimin e procesit. Përgatitja e tezave të provimeve nga titullarët e lëndëve në bashkëpunim me personelin akademik tregon një qasje kolektive dhe të koordinuar, e cila është thelbësore për ruajtjen e cilësisë në vlerësim. Miratimi i tezave nga përgjegjësi i departamentit përpara zhvillimit të provimeve siguron një nivel të lartë të mbikëqyrjes dhe konformitetit me standardet e përcaktuara. Pjesëmarrja e dy anëtarëve në komisionet e provimeve, e dokumentuar në procesverbalet përkatëse, është një praktikë e mirë për të siguruar integritetin e procesit të vlerësimit. Rekomandojmë vazhdimin e kësaj praktike, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe përgjegjshmërisë në çdo hap të procesit të vlerësimit. Kjo do të ndihmojë në ruajtjen e standardeve të larta akademike dhe në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit të vlerësimit. Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit KMP

	Evidenca 10. Rregullore e departamentit DEFKF Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Institucioni ka formalizuar vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale, duke siguruar që çdo provim të shoqërohet me komente dhe feedback për studentët. Format i tezës lejon që personeli akademik të reflektojë mbi rezultatet e çdo pyetjeje dhe të ofrojë komente ku është e nevojshme, duke ndihmuar në identifikimin e fushave përmirësimi. Sesioni sqarues është një iniciativë e mirë për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë studentëve. Ky proces ofron mundësinë për të adresuar problematikat e konstatuara dhe për të orientuar studentët për strategjitë e përmirësimit në të ardhmen. Kjo qasje jo vetëm që nxit një kulturë të mësuarit, por gjithashtu ndihmon në forcimin e marrëdhënies midis studentëve dhe pedagogëve. Evidencat e paraqitura, përfshirë rregulloret dhe udhëzimet, mbështesin këtë qasje dhe tregojnë angazhimin e institucionit për të ofruar një vlerësim të plotë dhe konstruktiv. Evidenca 9. Rregullore e programit të studimit KMP Evidenca 10. Rregullore e departamentit DEFKF Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin Evidenca 35. Formatet e kontrollit të njohurive të dijeve (teza, detyre kontrolli, ese)
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UMSH ka vendosur masa të qarta dhe të strukturuar për të parandaluar plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe punime. Këto veprime konsiderohen shkelje të rregullave dhe janë të detyrueshme për t'u raportuar dhe shqyrtuar nga Këshilli i Etikës. Angazhimi i institucioneve për të adresuar këto shkelje është thelbësor për ruajtjen e integritetit akademik. Procedurat e parashikuara për ndëshkimin e shkelësve, nga vërejtja me gojë deri në përjashtim nga universiteti, janë në përputhje me shkallën e thyerjes së rregullave. Kjo krijon një mjedis të sigurt për të gjithë studentët dhe nxit një kulturë përgjegjësie. Evidencat si Kodi i Etikës dhe syllabuset përkatëse mbështesin këtë qasje dhe tregojnë përkushtimin e institucionit për një mësimdhënie dhe vlerësim të drejtë dhe të ndershëm. Evidenca 23. Kodi i Etikës dhe Rregullore e Këshillit të etikës Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Institucioni ka krijuar një sistem të qartë dhe efikas për vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve, duke siguruar që rezultatet të bazohen në meritë. Sekretimi i provimeve garanton një vlerësim të drejtë dhe individual, duke shmangur çdo formë ndikimi të jashtëm. Korrigjimi i provimeve nga pedagogët e lëndës, nën mbikëqyrjen e titullarit, siguron një standard të lartë të cilësisë në procesin e vlerësimit. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Studentit (SMS), regjistrimi i pikëve në procesverbalin analitik brenda pesë ditëve pas provimit ofron transparencë dhe ndihmon studentët të marrin informacionin e nevojshëm në kohë. Kjo evidentohet përmes evidencave të dokumentuara, si syllabuset dhe udhëzimet për procedurat e provimeve, por edhe nga përgjigjet e studentëve dhe personelit akademik gjatë takimeve që u zhvilluan në institucion. <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe informacioneve të mbledhura gjatë vizitës në institucion konstatojmë se UMSH ka krijuar një strukturë të qartë dhe të rregullt për të garantuar të drejtat e studentëve në lidhje me vlerësimin e tyre. Informimi për rezultatet paraprake përmes sistemit SMS është një hap pozitiv që lejon studentët të kenë akses të menjëhershëm në informacionin e tyre. Organizimi i seancave sqaruese, ofron mundësinë për të diskutuar dhe verifikuar rezultatet, duke inkurajuar një kulturë transparence. Gjatë këtyre seancave, studentët kanë mundësinë të kërkojnë sqarime dhe, në raste të caktuara, të ndryshojnë vlerësimin, sipas udhëzimeve të përcaktuara.

Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura për ankimimin e vlerësimit është gjithashtu e detajuar dhe e dokumentuar, duke filluar nga shqyrtimi nga Dekani dhe përfshirja e komisioneve përkatëse. Kjo siguron që çdo kërkesë të trajtohet me seriozitet dhe në përputhje me rregullat e institucionit. Procesi i dokumentimit dhe ruajtjes së të dhënave është thelbësor për transparencën dhe përgjegjshmërinë. <i>Evidenca 34. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni garanton një vlerësim të drejtë dhe transparent, duke u bazuar në meritën individuale të çdo studenti dhe duke përfshirë një proces efektiv ankimimi. Kjo qasje siguron integritetin e procesit të vlerësimit, duke i mundësuar studentëve një mundësi të drejtë për të shprehur shqetësimet e tyre dhe për të marrë një përgjigje të paanshme dhe të argumentuar ndaj ankesave të mundshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” është projektuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Ndarja e lëndëve dhe përmbajtjeve të ofruara lejon një progresion gradual në njohuri nga një semestër në tjetrin, duke kombinuar njohuritë teorike me ato praktike. Kjo qasje gjithëpërfshirëse trajton çështje konkrete dhe nxit kreativitetin, duke e bërë programin të përshtatshëm për nevojat e tregut dhe kërkesat profesionale. Studentët janë të përgatitur për të operuar me profesionalizëm dhe integritet, brenda një kornize teorike solide. <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit KMP</i> <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP</i>

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme, përfshirë teknologjinë e informacionit, shkencat humane dhe sociale, si dhe komunikimin. Kurrikula është projektuar për të ofruar një balancë të mirë midis formimit teorik dhe praktik. Përfshirja e lëndëve si Informatika, Gjuhët e Huaja, Ekonomia, Filozofia, Sociologjia dhe Psikologjia në planin mësimor kontribuon në një zhvillim të plotë të studentëve, duke i pajisur ata me aftësi që janë thelbësore për suksesin në fushat e komunikimit dhe ndërveprimit. Këto lëndë ndihmojnë në formimin e njohurive të nevojshme për të kuptuar dinamizmin e shoqërisë moderne dhe për të komunikuar në mënyrë efektive në një kontekst ndërkulturor. Evidencat e paraqitura, si plani mësimor dhe syllabuset, demonstrojnë angazhimin e institucionit për të siguruar një arsimim të gjithanshëm dhe cilësor. <i>Evidenca 6. Plani Mësimor KMP</i> <i>Evidenca 7. Plani mësimor KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit KMP</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Mbështetur në përmbajtjen e dokumentuar përmes syllabuseve të lëndëve, por edhe disa prej instrumenteve të përdorur në kuadër ruajtjes dhe zhvillimit të cilësisë vlerësojmë se programi i studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” është i strukturuar në mënyrë që të sigurojë një vlerësim të qartë dhe të detajuar të kompetencave dhe aftësive që studenti fiton gjatë lëndëve. Syllabuset e miratuara për vitin akademik përfshijnë kriteret të qarta për matjen e rezultateve të studentëve, duke përfshirë analizën e performancës së tyre gjatë semestrit. Në përfundim të çdo lënde, personeli akademik angazhohet në vlerësimin e aftësive të fituara nga studentët dhe evidenton rezultatet përmes statistikave të sezonit të provimeve. Pjesëmarrja e studentëve në pyetësorët e vlerësimit të pedagogëve dhe lëndëve ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe në përshtatjen e tij me nevojat e studentëve. Rishikimi periodik i programit dhe i syllabuseve nga njësia përgjegjëse, në përputhje me përvojën didaktike dhe reagimet e

	studentëve, është një praktikë e rëndësishme për ruajtjen e cilësisë. Orientimi i studentëve nga titullari i lëndës mbi çështjet më të rëndësishme dhe mënyrat e aplikimit të tyre në praktikë është thelbësor për përgatitjen e tyre profesionale. <i>Evidenca 14. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit "Komunikim dhe marrëdhënie me publikun" e realizon mësimdhënien mbi bazën e kompetencave, duke u ofruar studentëve mundësinë për të zhvilluar njohuritë e fituara në laboratorë dhe në praktikën profesionale. Integrimi i njohurive teorike me praktikën në terren krijon një mjedis të favorshëm për aplikimin e aftësive dhe përgatitjen për tregun e punës. Praktikat profesionale janë një element kyç i këtij programi, pasi ato lejojnë studentët të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale dhe të krijojnë kontakte të vlefshme në lidhje me mundësitë e punësimit. Angazhimi në punën grupore, veçanërisht përmes rasteve studimore dhe detyrave të kursit, inkurajon bashkëpunimin dhe diskutimin konstruktiv, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të rëndësishme për karrierën. Personeli akademik luan një rol të rëndësishëm në mbështetje të diskutimeve dhe krijimin e një klime inovative, që nxit idetë dhe kërkimin shkencor. Strategjia e ndërkombëtarizimit të UMSH-së promovon bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke ndihmuar në mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Të gjitha këto u pohuan si nga studentët, po ashtu edhe nga personeli akademik me të cilin u zhvilluan takime në institucion. <i>Evidenca 39. Strategjia e Ndërkombëtarizimit</i> https://www.umsh.edu.al/c/182/erasmus- https://ëëë.umsh.edu.al/d/375/mundesi-te-reja-per-studentet-dhe-stafin-akademik-te-umsh
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Programi i studimit demonstroi një angazhim të kënaqshëm nga personeli akademik për të ofruar orë të hapura dhe seminare, duke integruar zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë. Ky angazhim reflektuar në përfshirjen e figurave të njohura me përvojë në fusha të ndryshme, si media, politika dhe arti, të cilët kontribuojnë me ekspertizën e tyre.

	Orët e hapura mësimore janë planifikuar në mënyrë strategjike dhe janë promovuar në rrjetet sociale, duke e bërë më të lehtë për studentët të angazhohen dhe të marrin pjesë. Kjo qasje nxit një atmosferë dinamike, ku informacionet e reja shkencore dhe teknologjike integrohen në mësimdhënie, duke i mbajtur studentët të informuar mbi çështjet më të rëndësishme që prekin jetën e tyre profesionale. Gjithashtu, organizimi i leksioneve të hapura mbi tema aktuale u jep mundësi studentëve të përfshihen aktivisht në diskutime dhe të zhvillojnë një kuptim më të thellë të koncepteve relevante. Kjo praktikë është e dobishme për të rritur angazhimin dhe për të siguruar që studenti të jetë në kontakt me zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. <i>Evidenca 72. Shembull Lektor i ftuar nga Departamenti. A. Krasta.</i> <i>Evidenca 73. Shembull Lektor i ftuar nga Departamenti. F. Hakorja.</i> <i>Evidenca 74. Leksion i hapur ne departament</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni ka ngritur struktura të posaçme në nivel institucional që promovojnë rritjen e vetëdijes dhe angazhimit për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programet e studimit. Këto struktura kontribuojnë në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe në krijimin e një mjedisi arsimor të orientuar drejt cilësisë, duke siguruar që proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies të jenë në përputhje me standardet më të larta akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në	Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar dhe punimin e diplomës, duke siguruar një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar për studentët. Rregullorja e programit të studimit “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” përcakton pragun e notës mesatare që studentët

rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	duhet të arrijnë për t'u kualifikuar për punimin e diplomës, e cila është bërë publike për të siguruar transparencë dhe qartësi. Përveç kësaj, studentët janë të pajisur me një program orientues dhe literaturën e nevojshme, e cila është gjithashtu e disponueshme në bibliotekë. Kjo qasje siguron që studentët të kenë burimet e nevojshme për t'u përgatitur siç duhet për provimin e formimit. Udhëzuesi i Provimit të Formimit, i cili është i aksesueshëm përmes këndit të njoftimeve të UMSH, ofron informacion të detajuar mbi procedurat që duhet ndjekur për diplomim, duke e bërë këtë proces të qartë dhe të kuptueshëm për studentët. Për më tepër, informacioni mbi realizimin e provimit të formimit shpërndahet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore gjatë gjithë vitit akademik, duke garantuar që çdo student të jetë në dijeni të kërkesave dhe procedurave të nevojshme. Kjo strukturë ka komunikim efektiv dhe reflektojnë angazhimin e institucionit për të siguruar një përvojë akademike të suksesshme dhe të organizuar për studentët e tij. Rekomandohet që të vazhdohet monitorimi dhe përmirësimi i këtyre procedurave për të garantuar vazhdimësinë dhe efikasitetin e tyre. Evidenca 9. Rregullore e programit KKMP Kreu VI, Neni 23; Evidenca 42. Pyetjet orientuese për provimin e formimit në programin KMP
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Institucioni ka krijuar një strukturë të qartë dhe mbështetëse për të asistuar studentët në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse. Që në fillim të vitit akademik, ofrohen informacione të detajuara mbi kurrikulën e programit të studimit, frekuentimin dhe literaturën e nevojshme. Syllabuset e çdo lënde jepen në mënyrë të aksesueshme nga pedagogu përkatës që në orën e parë në auditor, duke siguruar kështu që studentët të jenë të informuar mbi përmbajtjen dhe kërkesat e lëndëve. Pedagogët, së bashku me tutorët akademikë të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, janë të angazhuar në orientimin e studentëve për sigurimin e literaturës dhe materialeve të nevojshme për provimin final dhe provimin e formimit. Kjo ndihmë është e vlefshme për të siguruar një përgatitje të plotë dhe të suksesshme. Përveç kësaj, organizimi i konsultimeve për grup-lëndët në të gjitha sezonet e provimit të formimit është një praktikë e mirë që ofron mundësi për mbështetje dhe sqarim për studentët, duke i ndihmuar ata të përgatiten më mirë për provimet.

	Kjo qasje tregon angazhimin e institucionit për të krijuar një ambient mbështetës dhe orientues, duke siguruar që studentët të kenë qasje në të gjitha burimet e nevojshme për suksesin e tyre akademik. Rekomandohet vazhdimi i këtyre praktikave dhe përmirësimi i komunikimit për t'i bërë ato akoma më të efektshme. <i>Evidenca 22. Shembull komunikimi në Classroom të tutorit akademik.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i provimit të formimit është strukturuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë tematika nga të gjitha fushat kryesore të programit të studimit. Kjo qasje siguron që studenti të testojë njohuritë e tij në mënyrë të balancuar dhe të drejtë, duke përfshirë lëndë të ndryshme me rëndësi dhe peshë specifike. Pjesëmarrja e stafit akademik në hartimin e provimit është një proces i mirëorganizuar, ku programi miratohet nga përfaqësuesit e departamentit dhe dekani, duke siguruar që të gjitha lëndët e nevojshme përfshihen në testim. Strukturimi i tezës, me 40% të pyetjeve që lidhen me formimin e përgjithshëm dhe 60% që përfshijnë specialitetin, është një mënyrë efektive për të siguruar që studentët të demonstrojnë njohuritë e tyre si në bazën teorike ashtu edhe në aplikimin e tyre praktik. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon studentët të përgatiten më mirë për provimin, por gjithashtu rrit transparencën dhe drejtësinë e procesit të vlerësimit. Informimi i studentëve me një program orientues dhe literaturën e nevojshme, që është gjithashtu e depozituar në bibliotekë, është një praktikë e mirë që ndihmon në mbështetje të tyre. Vlerësimi i njohurive nga gjithë vitet akademike, si dhe përfshirja e lëndëve dhe moduleve kryesore, tregon angazhimin e institucionit për të ofruar një edukim të plotë dhe cilësor. <i>Evidenca 37. Format i tezës së provimit të formimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.	Studentët e programit të studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me publikun i përmbyllin studimet e tyre me provim formimi për të cilin marrin një program orientues së bashku me literaturën e nevojshme, i cili depozitohet nga departamenti përkatës edhe në Bibliotekë. Publikimi i materialeve orientuese dhe literaturës së nevojshme, së bashku me udhëzuesin për provimin e formimit, është një praktikë e mirë që ofron transparencë dhe qartësi për studentët. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë më mirë pritshmëritë dhe kërkesat e procesit të diplomimit.

Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<i>Evidenca 9. Rregullore e programit KMP Kreu VI, Neni 23</i> <i>Evidenca 40. Udhëzuesi i provimit të formimit</i> <i>Evidenca 42. Pyetjet orientuese për provimin e formimit në programin KMP viti akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia bazë, në bashkëpunim me FDSHH, ka ofruar një mbështetje të vazhdueshme për studentët e programit të studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke i asistuar në kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të nevojshme për zhvillimin e aftësive të tyre akademike. Kjo mbështetje është thelbësore për suksesin e studentëve në realizimin e detyrimeve të programit mësimor. Gjatë takimit me studentë, u konstatua gjithashtu se personeli akademik ka luajtur një rol aktiv në udhëheqjen e tyre për gjetjen e literaturës së duhur dhe në ofrimin e asistencës për vëzhgime në terren. Kjo është një praktikë shumë e dobishme, pasi lejon studentët të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale dhe të zhvillojnë aftësi analitike dhe kërkimore. Disponimi i mjediseve të UMSH për studentët është një tjetër aspekt pozitiv që kontribuon në mbështetje të punës studimore. Mjediset e përshtatshme për kërkimin dhe analizën janë të domosdoshme për të siguruar që studentët të kenë mundësinë të praktikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në një ambient profesional.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Programi i studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun ndjek një qasje të qartë dhe të strukturuar për vlerësimin e studentëve në përfundim të provimit të formimit. Sipas rregullores, çdokush që merr pjesë në këtë provim vlerësohet me një notë nga komisioni, që është një praktikë standarde dhe e pranuar në institucionet akademike. Kjo qasje garanton transparencë dhe objektivitet në vlerësimin e studentëve, duke siguruar që ata që arrijnë notat kaluese mbyllin me sukses ciklin e parë të studimeve. Kjo është e rëndësishme për motivimin e studentëve dhe për të siguruar që ata ndihen të vlerësuar për arritjet e tyre akademike. <i>Evidenca 9. Rregullore e programit KMP Kreu VI, Neni 23</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për	UMSH garanton një proces të qartë dhe të strukturuar për pajisjen e studentëve të programit të studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun me diplomën dhe suplementin e diplomës pas përfundimit të studimeve. Kjo është një praktikë e rëndësishme, pasi siguron që studentët të kenë dokumentet zyrtare të nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike ose profesionale.

arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pajisja me diplomë dhe suplementin e diplomës përputhet me kërkesat e MAS për arsimin dhe reflekton një angazhim për të ofruar një arsimim të cilësisë së lartë. Njohja zyrtare e titullit “Diplomë Bachelor në Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është një hap i rëndësishëm për çdo student, duke u ofruar atyre mundësi të reja në tregun e punës. Një tjetër aspekt pozitiv është disponimi i një kopjeje zyrtare të programit të studimit për studentët. Ky dokument është i rëndësishëm për studentët, pasi ofron një pasqyrë të plotë të përmbajtjes së arsimimit të tyre dhe mund të shërbejë si referencë për të ardhmen. Procesi i kërkesës për këtë kopje është i qartë dhe i strukturuar, duke lehtësuar aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm. <i>Evidenca 43. Modeli i diplomës për programin KMP;</i> <i>Evidenca 44. Modeli i Suplementit të Diplomës për programin KMP</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e programit Bachelor KMP, Kreu VI, Neni 23;</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Kreu X, Neni 53, 54</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni, përmes Sekretarisë Mësimore, ka vendosur një sistem të qartë dhe të organizuar për ruajtjen e dokumentacionit të studentëve. Kjo praktikë është e rëndësishme për të siguruar që çdo student të ketë një dosje personale të plotë, e cila përmban të gjitha të dhënat e nevojshme gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke përfshirë regjistrimin, notat dhe çdo informacion tjetër relevant deri në diplomim. Arkivimi i dosjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi garanton mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve dhe siguron që informacioni të jetë i aksesueshëm nëse kërkohet. Kjo është një masë e rëndësishme për transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucionit ndaj studentëve.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe të strukturuar për përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse të studentëve në programin e studimit, duke i pajisur ata me dokumentacionin përkatës dhe të miratuar nga ministria përkatëse për arsimin. Institucioni ka hartuar rregullore specifike për provimet përfundimtare dhe punimet e diplomës, ndërsa struktura përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë asistencë dhe orientim për studentët në përzgjedhjen e temave të diplomës dhe në realizimin e matjeve, analizave apo testeve. Pas përfundimit të provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, studentët</i>

	<i>vlerësohen me notë, ndërsa institucioni ruan kopje të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar përmbushjen e të gjitha standardeve të kërkuara për dokumentimin dhe cilësinë e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga UMSH, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në programin e studimit Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” përmbushin kriteret ligjore për nivelin e kualifikimit për mbulimin e lëndëve dhe moduleve dhe eksperiencës në përputhje me këtë program studimi. Njësia bazë e programit të studimit, që është Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave (DEKFK) përcakton fushën e kompetencës dhe nivelit akademik të stafit si atyre PAE dhe PAK (në bashkëpunim me Rektoratin). Gjithashtu, njësia bazë organizon dhe mban të gjitha të dhënat për programin e studimit për personelin akademik sipas kualifikimeve, ndarjen e ngarkesës mësimore si edhe në angazhimin në ngarkesa të tjera gjatë vitit akademik. Ky informacion pasi merret nga Departament përcillet edhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo Zyrë administron edhe dokumentacionin për proceset e rekrutimit dhe plotësimin e kushteve të kontratave për gjithë stafin akademik dhe ndihmës akademik.						
	Kualifikimi i stafit akademik të	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK

programit të studimit						
Prof.Dr	1		1		1	
Prof.As.Dr	2		2		2	
Dr	16	1	16	1	16	1
MSc						
Total	19	1	19	1	19	1

Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP

Evidenca 26. CV e stafit akademik të programit të studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun

Evidenca 47. Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Mbështetur në dokumentacioni e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se UMSH kujdeset që si stafi akademik ashtu edhe ai mbështetës të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ngarkesa e pedagogeve është brenda normave të caktuara. Nga shikimi i tabelës ku paraqitet ngarkesa akademike e stafit për vitin akademik 2023-2024, lidhur me programin e studimit Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” rezulton se rreth 93% ngarkesës mësimore orë në auditor mbulohet nga staf akademik efektiv/ i brendshëm dhe vetëm 7% nga personeli me kontratë, PAK.

Nga analiza e stafit mësimdhënës për vitin mësimor aktual, rezulton se:

- Lëndët Bazë (A) 34 ECTS, ose 19%
- Lëndët Karakterizuese B 92 ECTS, ose 51%
- Lëndët Ndërdisciplinare/ Integruese (C) 26 ECTS, ose 14%
- Lëndët Plotësuese formuese (D) 20 ECTS, ose 11%
- Punimi i diplomës/ provimi 8 ECTS, ose 4%

Vetëm lëndët “Hyryje në menaxhim”, Veprimtari Formuese A me 4 ECTS, që zhvillohet në vitin e parë dhe “Negociatat dhe zgjidhja e konflikteve” Veprimtari Formuese B, me 6 ECTS, që zhvillohet në vitin e tretë, jepen nga staf akademik me kontratë, PAK.

Sipas dokumentacionit plotësues të marrë gjatë vizitës në institucion Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave (DEKFK) ka 12 pedagogë efektivë. PAE, ndërsa në programin e studimit Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” japin mësim 17 pedagogë që janë PAE dhe 2 pedagogë që janë PAK.

Evidenca 47. Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun

Evidenca 7. Pani mësimor i KMP i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024

	<i>Evidenca plotësuese gjatë vizitës në UMSH.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analizimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të përcjellë nga UMSH, dhe, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik ka treguar qëndrueshmëri, kjo si përsa i përket programit të studimit, ashtu edhe Departamentit DEKFK. <i>Evidenca 41. Lista e lektoreve dhe pedagogeve të angazhuar në programin KMP (bashke me lendet)</i> <i>Evidenca 47. Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UMSH ka hartuar procedura të përcaktuara lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore. Sipas “Rregullores së organizimit të UMSH” dhe sipas “Përmbledhjes së procesit të rekrutimit” institucioni ka të ndërtuara edhe procedurat e rekrutimit bazuar edhe në statusin e tij dhe në kuadrin e përgjithshëm rregullues. Njoftimet publikohen në faqen online të universitetit. Përzgjedhja e stafit kalon në disa faza seleksionimi, duke filluar që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/intervistimit. Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevojës që ka programi i studimit. Procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve janë të përcaktuara edhe në rregulloret e UMSH <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49. Përmbledhje e procesit të rekrutimit</i> https://ëëë.umsh.edu.al/d/492/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se UMSH ka burime njerëzore edhe personel ndihmës akademik që është i mjaftueshëm për të realizuar programin mësimor të Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ pati kontakt me personalin ndihmës që asiston në këtë program studimi, si të lidhur me laboratorët e Teknologjisë së Informacionit, sekretarinë, apo projektet që mbështesin studentët.

mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ vëren se institucioni, Zyra e Burimeve Njerëzore, ka mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar me programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” duke i përmbledhur të gjitha informacionet në dosje individuale për stafin. Në Rregulloren e Programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” është përcaktuar se cili është niveli akademik që duhet të ketë stafi i këtij programi studimi. Informacioni mbi stafin akademik fillimisht është në departamentin DEKFK dhe me pas përcillet në zyrën e Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u morëm me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit, si për staf Akademik PAE dhe PAK. GVJ konstaton se (zyra) dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi arsimin, në të gjitha nivelet; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dosja përmban edhe vlerësimin që i është bërë pedagogut nga studentët; (v) Kontratat e punës në vite, etj. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49. Përmbledhje e procesit të rekrutimit</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni ka një listë të plotë të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis UMSH dhe institucioneve arsimore dhe jo arsimore që zgjerojnë mundësitë e të nxëniet për studentët. Kështu UMSH ka marrëveshje në kuadër të programit Erasmus + me 32 universitete të huaja në vende si Bullgari Estoni, Greqi, Itali, Poloni, Turqi, Spanjë, etj. Po ashtu UMSH ka nënshkruar 40 marrëveshje me institucione akademike dhe joakademike brenda dhe jashtë vendit. Ndërsa liston edhe bashkëpunime me 59 biznese private, organizata joqeveritare, organizma shtetëror, ku përfshihen banka, ndërmarrje private, bashki, etj. <i>Evidenca 13. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i>

specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni praktikant mësimore për këtë nivel të programit të studimit Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” zhvillohen në universitet. Praktika zhvillohet si një lëndë dhe u jep njohuri mjaft të rëndësishme për tregun e punës, si ndërtimi i CV dhe i një letre shoqëruese, praktikohet intervistimi dhe përgatitja paraprake që duhet përpara një interviste pune, mësohen disa nga “Soft skills” që duhet të shoqërojnë të studentin krahas formimit teknik dhe profesional. <i>Evidenca 14 Syllabuset e lendeve te ofruara per 2023-2024</i> <i>Evidenca 16. Udhëzim dhe dosja e praktikës Bachelor</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit të studimit. Institucioni ka procedura të rregullta rekrutimi, mbledh dhe ruan dokumentacionin mbi personelin akademik të përfshirë në programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve	UMSH e zhvillon vitin mësimor 2024-2025 në vendndodhjen Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me ambientet e universitetit si për klasat mësimore, laboratorët, zyrat e pedagogëve, si edhe ambientet mbështetëse, të përbashkëta, etj. Nga informacioni i përcjellë rezulton se sipërfaqja totale e godinave ku është vendosur aktualisht është 3860 m². Godina pesëkatëshe

mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	është me kontratë qiraje 10-vjeçare, ndërsa godina në katin e dytë të një ndërtese 2-katëshe është në pronësi të “Mesdheu Education” sh.p.k. Në katin e parë/bodrum (540m²) të godinës 5-katëshe janë të vendosura Biblioteka 107m², një sallë konferencash me 60 vende dhe 104m² dhe ambiente të tjera ndihmëse. Në katin e parë (468 m²) janë të vendosura administrata dhe një bar- bufe në shërbim të studentëve si edhe ambiente ndihmëse dhe sanitare. Në katin e parë janë të vendosura një sallë e madhe seminar me 101.7 m², tre salla seminaresh me sipërfaqe 47 m² dhe tre kabina pedagogesh si edhe ambientet e përbashkëta, tualete etj. Në katin e dytë (517 m²) janë të vendosura një sallë e madhe seminar me 110.m², gjashtë salla seminaresh me sipërfaqe të ndryshme dhe dy kabina pedagogesh si edhe ambientet e përbashkëta, tualete etj. Në katin e tretë (517 m²) janë të vendosura një sallë e madhe seminar me 110 m², arshiva tre salla seminaresh dhe tre kabina pedagogesh si edhe ambientet e përbashkëta, tualete etj. Në katin e tretë (497 m²) janë të vendosura zyrat e Rektorit, Dekanit, Shefave të departamenteve, zyra e pedagogëve. Kati i dytë i godina dykatëshe ka një sipërfaqe prej 804m² dhe ka 2 salla leksionesh, 8 salla seminaresh dhe 3 ambiente zyrash krahas edhe ambienteve të përbashkëta, tualete etj. <i>Evidenca 50. Relacion i verifikimit të godinës</i> <i>Evidenca 51. Urdhër për higjienën dhe zjarrin</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ vëren se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike, të IT të nevojshme në realizimin e procesit mësimor. Klasat janë të pajisura me ëhiteboard dhe mundësi për të lidhur projektorin gjatë mësimdhënies. <i>Evidenca 50. Relacion i verifikimit të godinës</i> <i>Evidenca 51. Urdhër për higjienën dhe zjarrin</i>

mësimdhënies-mësimnxënies.				
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ vëren se mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike dhe të TI të nevojshme në realizimin e procesit mësimor. Ky program studimi, bazuar në objektivat specifike formuese të tij, nuk ka nevojë për laboratorë me pajisje specifike, por për përdorimin e kompjuter dhe aksesit në Internet. <i>Evidenca 50. Relacion i verifikimit të godinës</i> <i>Evidenca 51. Urdhër për higjienën dhe zjarrin</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në universitet, GVJ vëren se universiteti ka laboratorë të TI të cilët kanë kompjuterë të përshtatshëm për zhvillimin e programit mësimore. Si kapacitetet hardëare, ashtu edhe softëare janë të përshtatshme për arritjen e objektivave formuese të programit. Programet Ëindoës, paketa e plotë janë të regjistruara në kompjuterët e laboratorëve në UMSH. <i>Evidenca 50. Relacion i verifikimit të godinës</i> <i>Evidenca 51. Urdhër për higjienën dhe zjarrin</i>			
Konkluzione	<i>UMSH vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme me salla, laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe mjedise të tjera mësimore për realizimin e procesit mësimdhënës në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” në UMSH dhe syllabuset e lëndëve të tij paraqesin një literaturë bazë dhe ndihmëse e cila gjendet edhe në bibliotekën e universitetit. Një pjesë e madhe e kësaj literature është

programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	në gjuhën shqipe dhe mjaft nga literatura plotësuese/ndihmëse është në gjuhë të huaja, kryesisht angleze. <i>Evidenca 53. Material për bibliotekën</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia kryesore e programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” në UMSH si edhe njësiti e tjera kryesore nxitin të përditësojnë literaturën e programeve të tyre. Marrëdhënia është e dyanshme, njësiti kryesore bëjnë kërkesa për shtimin e literaturës ashtu si edhe biblioteka raporton për hyrjet e reja që i shtohen asaj. Gjatë periudhës 2020-2023 rreth 27 tituj me studime të profesorëve të UMSH dhe me gjerë i janë shtuar bibliotekës së UMSH. <i>Evidenca 53. Material për bibliotekën</i> <i>Evidenca 54. Shembull kërkesë për libra DEKFK</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMSH ka një bibliotekë mjaft të pasur në tituj dhe në literaturë që përfshin fushat e studimit që realizohen në këtë institucion. Edhe nga vizita në institucion u vu re përdorimi i bibliotekës nga studentët dhe pasja e një numri të larmishëm titujsh edhe të shkencave të komunikimit. Sipas rregullores së bibliotekës studentët mund të përdorin lirisht titujt aty. Biblioteka ndodhet në një sipërfaqe prej 107 m2. (Me disa ambiente nga 20-90 m2), edhe me poste studimi që mund të përdoren nga studentët. <i>Evidenca 53. Material për bibliotekën</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Nga dokumentacioni i përcjellë nga institucioni rezulton se janë rreth 5000 tituj dhe 26,424 kopje fizike të librave. Përbërja e këtij fondi është si me tekste mësimore, universitare, libra dhe revista shkencore, apo botime të tjera në mbështetje të programeve të studimit. Edhe leksionet e përgatitura nga pedagogët dhe literatura plotësuese që i shërben detyrave të kursit apo punimeve të diplomave plotësojnë fondin e bibliotekës. <i>Evidenca 53. Material për bibliotekën</i>

specifikës së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka elektronike ka 17 mijë tituj në formatin elektronik të aksesueshëm për të gjithë nëpërmjet faqes online të universitetit, Në vitin 2022, biblioteka e UMSH është bërë anëtare me të drejta të plota të COBISS, që është një projekt/rrjet që përfshin shërbimet online të bibliotekave, rrjet ky që përfshin vendet e Evropës Juglindore, duke njëtrajtësuar edhe sistemin e katalogizimit. UMSH, përmes Shoqatës së Bibliotekave të Shqipërisë është pjesë e rrjetit online EIFL (Electronic Information for Libraries) për përdorimin e platformës elektronike Edëard Elgar Publishing. Evidenca 53. Material për bibliotekën http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	UMSH ofron mundësinë e përdorimit të këtyre platformave pa pagesë për studentët. Kompjuterët e vendosur në sallë ofrojnë mundësinë e përdorimit të tyre nga studentët përgjatë gjithë orarit, duke u ndihmuar në realizimin e detyrave të tyre.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e bibliotekës janë 09.00 - 20.00 në ditët e javës, pa fundjavat. Evidenca 53. Material për bibliotekën Informacion i marrë gjatë vizitës në institucion
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e	Njësitë kryesore dhe bazë të UMSH paraqesin kërkesat e tyre për literaturë dhe pasurimin e bibliotekës në çdo vit akademik. Departamentet informohen për hyrjet e reja në fondin e bibliotekës. Evidenca 53. Material për bibliotekën Evidenca 54. Shembull kërkesë për libra DEKFK

shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë si edhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se programi i studimit ka literaturën e nevojshme dhe të përditësuar. UMSH ka edhe një bibliotekë të pasur me tituj fizikë si edhe është pjesë e rrjetit online EIFL (Elektronik Information for Libraries) për përdorimin e platformës elektronike Edëard Elgar Publishing. GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se institucioni përdor sistemin/programin SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve) nëpërmjet të cilit menaxhohet informacioni personal për ecurinë e studentëve të të gjitha programeve të studimit nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Studentët dhe stafi akademik kanë llogaritë e tyre personale për të ndërvepruar në procesin akademik. Sipas sistemit SMS edhe pedagogët mund të menaxhojnë punën e tyre si gjetjen e informacionit për grupet mësimore, hedhjen e notave, të kontrollojë kërkesat e ardhura nga studentët për përmirësim të notave apo për lëndë ekstra-kurrikulare, të kontrollojë planet mësimore dhe bllokojnë dhe

	zhbllokojë studentët për frekuentimin e lëndëve ku jep mësim, videot tutoriale, njoftimet dhe statistikat e provimeve. Të dhënat e sistemit janë në format elektronik dhe në letër në regjistrat në Sekretarinë Mësimore. Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformës elektronike http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	UMSH ka sistemin/programin SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve). Ky sistem është i dedikuar për procesin mësimor dhe jep akses të dedikuar për secilin nga stafi akademik dhe studentët dhe ka të regjistruar dhe të përditësuar informacionin e nevojshëm për lëndët e programit të studimit, për çdo semestër, akses në literaturën e lëndëve, si dhe pedagogët përgjegjës për lëndët. Njësitë bazë dhe ndihmëse dhe persona të përcaktuar qartësisht nga rregulloret dhe udhëzimet përkatëse janë të angazhuar në mirëadministrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Regjistrat fizikë të lëndëve dhe procesverbalet e provimeve administrohen nga Sekretaria Mësimore. Evidenca 38 Manual i përdorimit të platformës elektronike http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UMSH ka sistemin/programin SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve) që funksionon që prej vitit 2017. Po ashtu që prej vitit 2020 përdoren edhe komunikimi me G-Suite dhe Zoom Cloud meeting. Këto forma u përdorën gjatë kohës së pandemisë Covid -19 dhe vijnë të përdoren si mënyra alternative studimi dhe shpërndarje të njohurive dhe detyrave. Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformës elektronike
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në UMSH, GVJ konstaton se

monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	institucioni e përdor sistemin SMS për të monitoruar aktivitetin akademik dhe administrativ lidhur me studentët. Raportet individuale për prezencën, kërkimin shkencor, frekuentimin e studentëve apo për mbylljen e procesit të vlerësimit të studentëve janë në dispozicion të njësive bazë dhe atyre kryesore. Institucioni ka një zyrë statistike që përpunon këto raporte për ti shërbyer menaxhimit sa më të shpejtë dhe efektiv. Evidenca 38 Manual i përdorimit të platformës elektronike http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se UMSH ka në funksion faqen zyrtare online, https://www.umsh.edu.al/ një faqe dinamike në të cilën publikohet informacion mbi programet e studimit, strukturën organizative të institucionit, fakulteteve, personelin akademik, aktivitete të ndryshme në lidhje me jetën akademike, studentore, ato të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Informacioni i publikuar është edhe në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze. Evidenca faqja online e universitetit https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8f286.pdf https://www.umsh.edu.al/eng/c/188/faculty-of-laë-and-humanities https://www.umsh.edu.al/media/660d083eedfe.pdf			
Konkluzione	GVJ vlerëson se USMH disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional (SMS) dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ vëren se universiteti bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare duke ndjekur disa procedura nga njësitet bazë për programet e studimit deri në miratimin përfundimtar nga Bordi i Administrimit. Muaji dhjetor është afati i miratimit të buxhetit për vitin akademik në vijim.

nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Administratori edhe Zyra e Menaxhimit Financiar janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit buxhetor të institucionit. Raportet dhe planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve/buxheti bëhet për të gjithë institucionin dhe jo për programe të veçanta studimi, pasi realizimi i planeve të tilla të detajuara është i pamundur për shkak se pedagogët japin mësim në disa programe studimi dhe po kështu edhe shpenzime të tjera materiale nuk është e mundur të ndahen sipas programeve. Në hartimin e planeve financiare/buxhetimin zbatohen rregullat e përcaktuar nga kuadri ligjor në fuqi, administrimi tatimor si edhe Statuti dhe Rregulloret e universitetit. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 55. Tabela e Raportit Financiar</i> <i>Evidenca 56. Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca 57. Raporti i Auditit</i> <i>Evidenca 69. Rregullore Bordi i Administrimit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit,	Plani i financimit bëhet për të gjithë institucionin dhe ai përmban të gjithë zërat e nevojshëm për mbarëvajtjen institucionale, për ecurinë e programeve të studimit. Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga tarifat, projektet dhe të ardhurat e tjera. Ndërkohë që shpenzimet përfshijnë për mësimdhënie dhe administrim, për punë kërkimore shkencore, për projekte kërkimi, shpenzime administrative të përgjithshme, shpenzime për investime dhe teknologji për të gjitha programet e studimit, etj. Bordi i Administrimit në UMSH është organi më i lartë administrativ i cili siguron edhe mbarëvajtjen financiare të institucionit. Zyra e Menaxhimit Financiar bën përlllogaritje për të ardhurat dhe shpenzimet, përlllogaritje të treguesve financiar dhe i raporton ato Bordit. Këto shërbejnë për prioritizimin e punës dhe programeve sipas njësive bazë, departamenteve dhe fakulteteve. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 55. Tabela e Raportit Financiar</i> <i>Evidenca 56. Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca 57. Raporti i Auditit</i> <i>Evidenca 69. Rregullore Bordi i Administrimit</i>

projektet dhe zëra të tjerë.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UMSH kryen auditim të përvitshëm. Auditimi kryhet nga zyra të licencuara të auditimit. Sipas RVB dhe dokumenteve të përcjellë nga institucioni, në vitin 2022 Croëe AL Sh.p.k. ishte shoqëria që kreu auditimin e pasqyrave financiare. Raportet e auditimit japin detaje dhe transparencën financiare për institucionin në tërësi. <i>Evidenca 56. Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca 57. Raporti i Auditit</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMSH analizon dhe monitoron treguesit financiarë të cilët prezantohen në Bordin e Administrimit për aprovim deri në dhjetor të vitit akademik. Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e organizmit të UMSH bëhen edhe hartimet e buxhetin dhe përshtatjet e tyre. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni mbi të ardhurat e pasqyruara në anekset e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm/Tabelave përmbledhëse rezulton shifra të ardhurash që sigurohen nga tre burime kryesore: • Tarifat e shkollimit; • Projektet, si edhe • Të ardhura të tjera. Nga raporti i RVB në vitet 2017-2022 institucioni ka pasur rritje graduale të të ardhurave zërin e tarifave që zë edhe pjesën kryesore të të ardhurave, dhe në dy vitet e fundit edhe në zërin e projekteve. <i>Evidenca 55. Tabela e Raportit Financiar</i> <i>Evidenca 56. Pasqyrat financiare</i>			
Konkluzione	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në UMSH, GVJ vëren se universiteti bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare duke ndjekur disa procedura nga njësitë bazë për programet e studimit deri në miratimin përfundimtar nga Bordi i Administrimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga tërësia e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, rregullore dhe baza nënligjore GVJ mendon se UMSH e bazon veprimtarinë e tij në një tërësi rregulloresh si të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Rregullore të Departamentit DEKFK. Edhe Rregullorja e programit mësimor rrjedh nga rregulloret kryesore. Rregullorja mësimore e “Rregullorja e programit të studimit KMP” përshkruan hapat nëpër të cilat duhet të kalojë i gjithë procesi me studentët që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin përfundimtar. Sipas nënpikave të veçanta, kjo rregullore jep kriteret e pranimit, tërësinë e programit të studimit, organizimin e mësimit, kontrollin e dijës, deri tek procesi i diplomimit. Të gjitha këto dokumentacione janë të bazuar në rregulloren e brendshme dhe Statutin e UMSH. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Aktet rregullatore të UMSH, duke nisur që nga Statuti i saj, Rregullorja e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Rregullorja e Departamentit DEKFK dhe më tej Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor KMP, garantojnë barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë studentët e programit të studimit. <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i>

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme në pranimin e studentëve në programet e ciklit të parë të studimit mbështeten në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Nr. 80/2015, Neni 74 që lidhen edhe me mesataren e notës që përcaktohet çdo vit nga Ministria e Arsimit. Kriteret e përgjithshme të pranimit të janë të vendosura edhe në faqen online të UMSH. Studentët e programit të studimit të ciklit të parë në komunikim nuk kanë kriteret të veçanta, pasi njohuritë e përgjithshme mjaftojnë dhe nuk kanë kërkesa specifike. Sipas rregullores mësimore “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP”, përcakton kriteret e pranimit në këtë program studimi kreu III Neni 12, pika 2 (të cituara më poshtë): <i>“Përzgjedhja e kandidatëve për tu pranuar në këtë program sipas drejtimeve bëhet nga një komision i caktuar nga dekani mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si edhe nga shqyrtimi i dosjen personale të kandidatit. Kandidatët renditen në bazë të plotësimit të kriterëve që i miraton Rectori për çdo vit akademik Ky komision, pas shqyrtimit të dosjeve paraqet për miratim listën e kandidatëve fitues, e cila shpallet nga Dekani.”</i> Në procesin e pranimit studentët njihen edhe me natyrën e programit të studimit që ata kanë përzgjedhur. Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit Shpallen fituesit: https://www.umsh.edu.al/media/64ea073d1190e.pdf si te aplikojmë: https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6E6mo4Qp-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/vieëform?pli=1
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të	Në rregulloren e programit të studimit “Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP”, janë të përcaktuara kriteret e pranimit në këtë program studimi. Po ashtu kjo rregullore përcakton edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve deri në procesin final të diplomimit. Informacioni gjendet lehtësisht në faqen web të UMSH Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit https://www.umsh.edu.al/media/64ea073d1190e.pdf https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6E6mo4Qp-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/vieëform?pli=1 https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet

aksesueshme nga publiku.	
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UMSH ka ndërtuar planin e tij për promovimin e programeve të studimit duke nisur që prej muajve të parë të vitit të ri. Një ndër mjetet janë edhe takimet informuese me gjimnazistët në shumë qytete të mëdha të vendit. Faqja online e UMSH është një burim i gjerë informacioni dhe ajo përditësohet në mënyrë periodike. Këto informacione janë kontakti i parë me studentët, dhe vijimësia lidhet me informacionin që jepet nga zyrtat specifike dhe nga pedagogët në varësi të programeve të studimit. Gjithashtu një burim i mirë janë edhe materialet e shkruara, fletëpalosje. Java e parë e fillimit të vitit shkollor është orientuese, me regjistrime, këshillime, etj. <i>Evidenca 8. Rregullore e Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit https://www.umsh.edu.al/media/64ea073d1190e.pdf https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Ëmo4Op-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKO/vieëform?pli=1 https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMSH ka ndërtuar një rregullore specifike për studentët me aftësi ndryshe e cila që në fillim thekson se kjo rregullore i bashkëngjitet statutit të universitetit dhe e shtrin veprimtarinë e saj në të gjitha fakultetet e UMSH. Rregullorja specifikon edhe pranimin e studenteve dhe statusin e tyre gjatë kohës që ndjekin programet mësimore. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i> <i>Evidenca 52. Rregullore për studentët me aftësi ndryshe</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	NA

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në faqen online të UMSH jepen edhe kriteret për marrjen e bursave në programet Bachelor. Ato mund të jenë si bursa ekselence ashtu edhe bursa e plotë sociale. Sipas faqes online: BURSË E PLOTË SOCIALE i akordohet aplikantëve nga grupet në nevojë (familje me ndihmë ekonomike dhe mesatare shumë të lartë, status jetimi, fëmijë dëshmorësh në polici, në forca të armatosura, me aftësi ndryshe, komunitetet e marginalizuara, etj të ngjashëm). Përfituesit e ruajnë këtë të drejtë për sa kohë kushtet sociale nuk ndryshojnë dhe plotësojnë kërkesat kontraktuale për përfituesit e bursave deri në përfundim të studimeve të një cikli akademik. – Përfitohet nëpërmjet APLIKIMIT online në faqen e UMSH-së. BURSË MBËSHTETËSE i akordohet deri në 3% e numrit të studentëve të rinj të regjistruar, për aplikantë me të ardhura relativisht të ulëta, Përfitohet nëpërmjet APLIKIMIT online në faqen e UMSH-së Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje të plotë me standardin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni GVJ vlerëson se janë disa mënyra që institucioni vë në dispozicion për studentët informacionet e nevojshme. Platformat SMS si edhe faqja online e UMSH japin të gjitha kriteret e nevojshme dhe informacionin e duhur për studentet për procedurat e fillimit të studimeve në programin e studimit. Gjithashtu, rregullorja e programit të studimit është dokumenti bazë që shërben për t'u dhënë studentëve gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit. I gjithë ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare online të universitetit. Një material mjaft i plotë informues është edhe “Udhëzuesi për studentët”. Java e parë e vitit akademik është gjithashtu edhe prezantuese me programet e studimit,

	pedagogët, lëndët etj. Ky informacion detajohet më tej nga pedagogët në çdo fillim të ciklit mësimor. Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP Evidenca 33. Udhëzuesi për studentët.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Mbështetur në legjislacionin aktual si edhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit si edhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, UMSH pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike. UMSH ka të qartësuar në faqen online si edhe në “Udhëzuesin për studentët” hapat/procedurat që i shërbejnë njohjes së studimeve të mëparshme. Sikurse jepet në faqen online të UMSH, transferim studimesh Bachelor kërkon disa dokumentacione si (i) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer; (ii) Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse; (iii) Vërtetim çregjistrimi; (iv) Fotokopja e noterizuar e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme; (v) Fotokopje e dokumentit të identifikimit; (vi) Dy fotografi personale. Evidenca 8. Rregullore e Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, syllabuset e lëndëve japin mënyrat e kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, për secilin program studimi. Gjithashtu kriteret e vlerësimit të studentëve janë të vendosura edhe në rregulloren mësimore të programit të studimit Bachelor KMP si edhe në rregulloren e departamentit. Pedagogët bëjnë prezantimin e këtyre kriterëve në çdo fillim të sezonit të ri akademik Evidenca 8. Rregullore e Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK Evidenca 14. Syllabuset e 2023-2024 (sipas lëndëve)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UMSH ka hartuar dokumentacionin bazë që ndihmon studentët për t'u njohur me procedurat e tyre për përfundimin e programit, nëpërmjet punimit të diplomës apo provimit përfundimtar. Janë disa dokumente të cilat japin informacion të duke filluar që nga rregulloret e përgjithshme, rregulloret e programit të studimit. Ky program studimi, Bachelor KMP, diplomimin e kryen me provim përfundimtar. Dokumenti “Pyetjet orientuese për provimin e formimit në programin KMP 2023-2024” është informacioni bazë që

	i shërbejnë studentit për të realizuar diplomimin nëpërmjet provimit përfundimtar. Afatet për diplomimin janë të përcaktuara edhe në kalendarin akademik që miratohet në fillim të vitit dhe bëhet publik për studentët. Gjithashtu, komunikimi me sekretarinë e departamentit jep informacion plotësues të rëndësishme për studentët. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e 2023-2024 (sipas lëndëve)</i> <i>Evidenca 42. Pyetjet orientuese për provimin e formimit në programin KMP 2023-2024</i>				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Një praktikë e rëndësishme në UMSH, në çdo fillim viti shkollor, është edhe java orientuese. Gjatë kësaj jave, pedagogë nga departamente të ndryshme japin informacion për studentët në varësi të programeve të studimit ku ata janë të interesuar. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe ZKSK e cila jep informacione plotësuese për këtë drejtim. Informacion mjaft i plotë gjendet edhe në broshurën e studimeve Bachelor. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 15. Broshura e programeve Bachelor</i> https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres				
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni GJV vëren se UMSH vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për	Dokumenti fillestar dhe më i rëndësishëm për studentët në fillimet e tyre është rregullorja e programit të studimit e cila jep gjithë informacionin e nevojshëm për strukturën organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.

strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Ky informacion jepet për studentët edhe nga Zyra ZKSK. Informacione jepen edhe gjatë këshillimit me stafin akademik përpara procesit të regjistrimit. Studentët informohen edhe për përdorimin e sistemit SMS dhe se si të marrin dhe të kryejnë proceset administrative dhe akademike online nëpërmjet këtij sistemi. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 15. Broshura e programeve Bachelor</i> https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët në UMSH, që në momentin e këshillimit akademik dhe regjistrimit në programin e studimit marrin informacion për programin e lëndëve. Më pas në javën e këshillimit dhe me informacionin nga sekretaria mësimore dhe takimi me pedagogët ata marrin edhe syllabuset e lëndëve, me informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuara lëndët dhe modulet mësimore, e veprimtaritë formuese. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve etj. Departamenti DEKFK ku zhvillohet programi i studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për aktivitetin mësimor. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 14. Syllabuset e 2023-2024 (sipas lëndëve)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informacioni për tregun e punës jepet në disa forma. Një ndër to është informacioni i përcjellë nga zyra ZKSK. Edhe departamenti DEKFK, po ashtu u përcjell informacione mbi kërkesat nga tregu i punës. Departamenti dhe Zyra ZKSK janë mjaft të përfshira në procesin e asistencës për punësimin e studentëve. Sikurse u mësua edhe gjatë vizitës në UMSH dhe nga dokumentacioni i përcjellë pjesë e kontaktit dhe qasjes me tregun e punës janë edhe shumë lektorë ose të ftuar që vijnë në mjaft prej lëndëve për të dhënë eksperiencat e tyre konkrete në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. UMSH organizon aktivitete vjetore me institucione private dhe zyrat e punësimit të studentëve lidhur me mundësitë e punësimit. Gjatë takimit të GVJ me studentët, ata u shprehën për mundësitë që u ofron UMSH nëpërmjet kontakteve me media të ndryshme dhe si kanë ndihmuar ato në vendosjen e lidhjeve dhe punësimet e pjesshme ose të plota gjatë dhe pas mbarimit të studimeve. https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres <i>Evidenca 67. Shembull lektori i ftuar nga Departamenti F. Hakorja</i> <i>Evidenca 72. Shembull Lektori i ftuar nga Departamenti, A. Krasta</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet	Informacioni i studentëve lidhur me programin e studimit jepet në forma të ndryshme. (Me nënshkrimin e kontratës së studimit në program,

në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	nëpërmjet broshurës së programeve Bachelor, nëpërmjet sistemit të komunikimit online, si edhe me sekretarinë mësimore). Që në fillim të procesit të regjistrimit, studentet krijojnë llogarinë e tyre të email dhe mundësinë e aksesit në SMS për të marrë gjithë informacionin e nevojshme. Kjo platformë krijon mundësinë edhe të komunikimit me pedagogët në distancë. Sistemi është mjaft i përdorshëm për studentët për dhënien e informacionit lidhur me kalendarin akademik, procesin mësimor, aktivitetet extrakurrikulare, etj. Studentët kanë në dispozicion edhe Bibliotekën që është e pajisur si me titujt fizike të librave, ashtu edhe me mundësinë e aksesit online. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 15. Broshura e programeve Bachelor</i> <i>Evidenca 58. Kalendar akademik 2023-2024</i> https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet https://www.umsh.edu.al/c/174/njoftime http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit mundëson lidhjen e studentëve me pedagogët, departamentin DEKFK dhe njësitë e tjera administrative në UMSH. Të gjithë studentët dhe pedagogët kanë llogarinë e tyre për të komunikuar online. Sistemi ka të gjithë informacionin për programin e studimit specifik. <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformave elektronike</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit, në përputhje të plotë me standardin. Ky informacion përcillet si në formatin e shkruar dhe nëpërmjet takimeve me personelin akademik dhe ndihmës, ashtu edhe nëpërmjet sistemit SMS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në Sekretarinë Mësimore të UMSH gjenden informacione të plota për statistikën e studentëve në hyrje dhe në dalje për secilin fakultet dhe program studimi. Edhe gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore u njohën me mënyrën e mbajtjes së informacionit dhe ruajtjen e tij sipas rregulloreve.																
	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>Studentë të regjistruar</th><th>Studente të transferuar</th><th>Studentë gjithsej</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>17</td><td>-</td><td>17</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>5</td><td>3</td><td>8</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>6</td><td>5</td><td>11</td></tr></table>	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej	2021-2022	17	-	17	2022-2023	5	3	8	2023-2024	6	5	11
	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej													
	2021-2022	17	-	17													
2022-2023	5	3	8														
2023-2024	6	5	11														
Dokumenti “Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve” jep informacione për studentët në vitin 2021-2024 për cilësinë e tyre në hyrje e cila varion nga 7.6- 8 si notë mesatare. Në vitin akademik 2023-2024 janë viti i parë i diplomimit të 18 studentëve në programin e studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”.																	
Sekretaria mësimore, me anë të regjistrave të saj, ka statistikën e studentëve të regjistruar në programet e studimit sipas viteve, rezultatet e provimeve, lëvizjet, largimet, cilësinë e studentëve në hyrje, etj.																	
	<i>Evidenca 47. Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me publikun.</i>																
	<i>Evidenca 60. Tabela cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i>																
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	Sekretaria Mësimore në UMSH disponon statistikën e programit të studimit “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”																
	<i>Evidenca 47. Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Komunikim dhe Marrëdhënie me publikun.</i>																
	<i>Evidenca 60. Tabela cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i>																

përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Sekretarinë Mësimore, gjendet dosja e çdo studenti me informacionin e duhur, më të dhënat e rezultateve në provime dhe ecurinë vit pas viti. Ky informacion është i ruajtur edhe në sistemin elektronik, si edhe në regjistrat e depozituar në sekretarinë mësimore. GVJ u njoh me këto regjistra gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformave elektronike</i> <i>Evidenca 59. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	UMSH e bazon veprimtarinë e tij në një set rregulloresh dhe aktesh të miratuara nga Rektorati dhe Bordi i Administrimit. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i> <i>Evidenca 38. Manual i përdorimit të platformave elektronike</i> <i>Evidenca 59. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre,	UMSH dhe departamenti DEKFK ndjekin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e studentëve në hyrje të programit dhe në dalje të tij. Raportet e hartuara shërbejnë për zhvillimin e ecurisë e punës më tej. Gjatë vizitës në departament, GVJ u njoh edhe me komunikimet e pedagogeve me studentët dhe orientimin që ata bëjnë për cilësinë dhe ecurinë e studimeve të tyre.

duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.				
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumenatcioni e përcjellë dhe informacionin plotësues të marrë gjatë vizitës në UMSH, GVJ vlerëson se universiteti mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna mbi numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim. UMSH ka edhe rrejtin Alumni dhe ndjek ecurinë e studentëve edhe pas përfundimit të studimeve, dhe zhvillon aktivitete promovuese me ish studentët, tashmë të diplomuar dhe të punësuar..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas Statutit, Kreun X, Neni 81 saktësohen të drejtat dhe e studenteve ku saktësohet se studentët kanë të drejtë “... të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Gjithashtu studentët janë të organizuar në Këshillin Studentor i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit dhe në strukturat mësimore dhe kërkimore. Këshilli Studentor ka dy organe Asamblenë e tij dhe Bordin Ekzekutiv të Këshillit Studentor. Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK Evidenca 61. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin	Këshilli Studentor dhe organet e tij drejtuese si Bordi Ekzekutiv dhe kryetari i tij zgjidhen çdo dy vjet me votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet duke përfshirë edhe cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.


mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Duke shikuar dokumentacionin e përcjellë dhe nga vizitat në universitet, GVJ vëren se mënyrat për përfshirjen e studentëve në organizmat vendimmarrëse dhe marrjen e mendimit të tyre ishin të ndryshme. Opinioni i studentëve merrej nëpërmjet pyetësorëve me frekuencë semestrale (dy herë në vit) dhe fokus grupeve. Një nga studentët e programit të studimit Bachelor në “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun” ka qenë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi. Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën për mundësitë që u ofron universiteti në diskutime dhe kontakte të afërta me pedagogët dhe departamentin. Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 61. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	UMSH organizon fokus grupe, pyetësorë për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit. Fokus grupet janë një mënyrë mjaft efektive për të marrë informacionin nga studentët. Në një nga shembujt e proces verbaleve të përcjellë nga institucioni, ishte zhvilluar takim/fokus grup për ecurinë e Semestrit të I 2023-2024 dhe aty janë të renditura çështjet që janë diskutuar si edhe komentet e studentëve. Në procesverbal ruhet anonimati i studentëve. Gjatë takimit me GVJ studentët dhanë një shembull për përshtatjen që ju bë lëndës së “Ekonomisë” e zhvilluar në vitin e parë, pas komunikimit dhe kontaktit që ata bënë në departament. NJSCZHK ka të planifikuar takime me studentët për të marrë mendime dhe shikuar mundësitë e përmirësimit për çështje të veçanta. Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 18. Kalendar i NJSBCZHK me Këshillin Studentor Evidenca 27. Procedurat e punës me Fokus Grupet Evidenca 28. Formular i vlerësimit të pedagogut nga studenti. Evidenca 61. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor

	<i>Dokumente të përcjella pas vizitës:</i> <i>Proces verbal i Fokus Grupit datë 16.01.2024</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e brendshme të universitetit si edhe rregullorja specifike e programit të studimit Bachelor KMP përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Specifikisht, mënyra e vlerësimit është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. Në fund të çdo semestri, studentët nëpërmjet pyetësorëve shprehin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor KMP</i> <i>Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK</i> <i>Evidenca 34. Udhëzim mbi proceduarat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët, GVJ vlerëson se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit si edhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, si me takime, nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore	Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ gjykon se UMSH ka procedura dhe njësi të posaçme për t'i shërbyer sa më mirë studentëve, bazuar edhe në aktet ligjore dhe rregullatore. UMSH ka të ngritur Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ZKSK. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH ka mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe

dhe aktet rregullatore të institucionit.	këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. <i>“Qëllimet që synon të realizojë Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës janë: (i) Të organizojë dhe drejtojë këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik; (ii) Të ofrojë këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; (iii) Të mbështesë Këshillin Studentor, i cili është një organizëm i pavarur në UMSH që përfaqëson dhe mbron interesat e studenteve; (iv) Të mbështesë njësitë bazë përgjatë procesit të praktikave mësimore dhe profesionale.</i> Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK Evidenca 62. Rregullore e ZKSK
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i informimit ka në themel të tij një strukturë që mbështetet fillimisht te Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Parimet bazë të ZKSK janë: (i) Mbështetja e studentëve në procesin e rritjes dhe vetënjohjes si dhe krijimin e mundësive që të shfrytëzojnë njohuritë e veta në dobi të zhvillimit të tyre të ardhshëm; (ii) Nxitja e studentëve në zgjerimin e horizontit të tyre për të qenë qytetarë aktivë; (iii) Mbështetja e studentëve për të rritur aftësitë e tyre për vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve; (iv) Ndihma e duhur që studentët të kuptojnë tregun e punës, mundësitë, rreziqet dhe sfidat. Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane Evidenca 10. Rregullore e Departamentit DEKFK Evidenca 62. Rregullore e ZKSK
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës i ndihmon studentët edhe në drejtim të aplikimeve për kurse trajnimi dhe përfshirjes në projekte të ndryshme, ashtu edhe për trajnime online dhe për internship-e. Funksioni i saj parësor është këshillimi gjatë kohëzgjatjes së procesit akademik të studentëve në të gjitha etapat deri në diplomim. Evidenca 62. Rregullore e ZKSK https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres

praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës bashkëpunon me njësitë e tjera administrative në UMSH dhe me zyrën ALUMNI si edhe mbledh dhe përpunon edhe të dhënat e studentëve pas diplomimit. Në faqen zyrtare online të universitetit https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni ndodhen edhe informacione plotësuese për alumni dhe aktivitetet e tyre Fuqizimi i rrjetit ALUMNI ka rol të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve të UMSH me tregun e punës, duke e integruar këtë në hartimin e programeve të reja të studimit. UMSH organizon aktivitete të ndryshme duke i dhënë një mundësi dhe shembull studentëve aktualë për të njohur dhe marrë eksperiencat e tregut të punës. Prej tre vitesh funksionon baza statistikore për ALUMNI e cila përditësohet. Në 2023 është bërë një anketim me 785 studentë të diplomuar në tre vitet e fundit për të shprehur opinionet e tyre mbi programet në UMSH, punësimin dhe faktin që 14% e tyre kanë hapur bizneset e tyre. Mbi 58% donin të ndiqnin edhe një program tjetër në UMSH dhe mbi 76% ishin të interesuar të ruanin lidhjet me universitetin. https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni Evidenca 17. Raporti Vjetor Alumni 2022-2023 Evidenca 62. Rregullore e ZKSK			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni dhe atë të marrë gjatë vizitës në universitet, GVJ gjykon se UMSH ka rregullore të brendshme dhe një udhëzim, dokumente këto të cilat evidentojnë mënyrat e mësimdhënies për t'i shërbyer sa më mirë studentëve dhe të nxënit. Eksperienca me kohën e Pandemisë së Covid 19 i ka vendosur në kërkim të formave të reja të mësimdhënies. Përdorimi i Google classroom vazhdon edhe pas kalimit të saj. Pedagogët e UMSH në këtë program studimi, gjatë vizitës u shprehën se atyre u janë bërë trajnime dhe i përdorin këto forma edhe në module të ndryshme mësimore. Udhëzimi me Nr. Prot 20100 i datës 29/10/2020 "Mbi mbarëvajtjen e zhvillimit të mësimin online për vitin akademik 2020-2021 në platformën G-Suite" shpjegon të gjithë procesin se si nëpërmjet e-mail të tyre studentët dhe pedagogët aksesojnë platformën për mësim, vendosin komunikim e ndërsjelltë pedagog-student, vendosin prezantimet dhe realizojnë detyrat. <i>GVJ sugjeron që ky udhëzim i mësimdhënies online të përditësohet dhe të plotësohet edhe me metodave alternative të mësimdhënies që nevojiten gjatë procesit mësimor.</i> Evidenca 1. Statuti i UMSH Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH Evidenca 22. Shembull komunikimi në classroom të tutorit akademik Informacion në faqen ëeb: https://www.umsh.edu.al/media/60ab6fcd2853.pdf miratuar nga Rektori me 29/10/2020
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	NJSBCZHK në UMSH është krijuar bazuar në Statutin dhe Rregullores së Organizimit të Brendshëm të institucionit. Kjo njësi bashkëpunon me të gjitha fakultetet dhe njësitë bazë dhe harton çdo vit një plan/kalendar të vlerësimit semestral ku janë të përcaktuar monitorimet. Një formë e re e monitorim/vlerësimit ishin edhe fokus grupet që zhvillonte UMSH. Fokus Grupet ruajnë anonimin e

akademik dhe ndihmësakademik.	pjesëmarrësve në përmbledhjen e informacioneve dhe organizohen me studentë. UMSH përdor edhe formatin vlerësues për pedagogun dhe lëndën. Ky vlerësim bëhet çdo semestër dhe plotësohet nga autoriteti drejtues si edhe një anëtar i NJSBCZHK. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 18. Kalendar i takimeve të NJSBCZHK me Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 19. Shembull Fokus grupi me studentët e komunikimit</i> <i>Evidenca 29. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 31. Organigrama e UMSH</i> <i>Evidenca 32. Plani i monitorimit të DEKFK</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Në grupet e vlerësimit të cilësisë dhe monitorimit të brendshëm përfshihen anëtarë të njëjësive bazë si edhe nga studentët. Përzgjedhja e studentëve bëhet nga Këshilli Studentor sipas kalendarit të takimeve me studentët. Këto takime janë të përmuajshme. NJSBCZHK zhvillon edhe fokus-grupe me studentët çdo semestër në të dy ciklet e studimit. Fokus-grupet janë të strukturuar me pyetje dhe përcjellin informacion në mënyrë anonime. Po ashtu studentët janë përfshirë edhe në anketime online për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve. <i>Evidenca 18. Kalendar i takimeve të NJSBCZHK me Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Mënyra e funksionimit të NJSBCZHK rregullohet me rregullore të veçantë. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Raportet periodike mbi vlerësimet, monitorimet dhe fokus-grupet që realizohen u dërgohen strukturave drejtuese të UMSH, por gjithashtu edhe pedagogëve sipas lëndëve përkatëse, si edhe drejtuesve të njëjësive bazë. Raportet janë edhe pjesë e diskutimeve

	në nivel dekanati dhe Rektorati për përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies në institucion. Në faqen online të UMSH, nënseksioni i sigurimit të cilësisë janë të publikuara https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise raportet vjetore që kjo njësi harton. Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) i dërgon të gjitha raportet e saj të monitorim/vlerësimit pranë departamenteve dhe fakulteteve. Këto shërbejnë për të zhvilluar takime me të gjitha njësitë dhe për të nxjerrë rezultate dhe për të promovuar përvojat pozitive. Në fund të çdo viti akademik pedagogët zhvillojnë takime në rektorat për matjen/ vlerësimin e performancës akademike. Të gjitha këto vlerësime administrohen nga Rektorati për t'i shërbyer si njësi baze e kryesore për të përmirësuar punën dhe ecurinë në rritje të cilësisë.			
Konkluzione	<i>Bazuar në informacionin e grumbulluar dokumentuar dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se UMSH ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave ka zhvilluar mekanizma të qartë monitorimi, ku janë të përfshirë edhe studentët dhe rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen edhe publike nëpërmjt raporteve edhe në faqen online të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe	Mbështetur në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë” UMSH ka ndërtuar një bazë rregullatore dhe një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Dokumentet kryesore mbi të cilat bazohet janë aktet rregullatore të aprovuara si Statuti, Rregullore e organizimit të UMSH. Kjo bazë rregullatore ka shërbyer për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Kjo njësi ka të hartuar edhe planin e tij të veprimit

me aktet rregullatore institucionale.	për monitorimin e cilësisë dhe arritjen e rezultateve. NJSBCZHK vepron mbi bazën e një rregulloreje e cila është e përditësuar dhe miratuar 28.082023. Rregullorja përshkruan misionin, qëllimin, fushat e veprimit, përbërjen e Njesisë, të drejtat dhe detyrimet, etj. Ajo ka të përcaktuara gjithashtu edhe punën dhe proceduara që ndjek njësia për të realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë. Të tilla janë të përcaktuara në rregullore edhe “grupet e punës për vlerësimin e kurrikulës”, “grupet ad-hoc”, kriteret për vlerësimin e stafit akademik, anketimet dhe përpunimi i tyre, vlerësimi i studentëve, etj. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 18. Kalendar i takimeve të NJSBCZHK me Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 30. Plan i punës i NJSBCZHK</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar (siç u listua më sipër), UMSH ka ngritur NJSBCZHK me objektiv themelor monitorimin dhe ruajtjen e brendshme të cilësisë. Gjithashtu UMSH ka ndërtuar edhe Planin Strategjik të zhvillimit të tij 2018-2023. Kjo Strategji ka të përcaktuar Misionin, Vizionin, fokusin në vitet në vijim, dhe një kapitulli i veçantë i është dedikuar “Cilësia dhe performanca Akademike”. Aty janë të detajuar edhe objektivat synimet në drejtim të cilësisë duke u fokusuar në dy standarde: standardet për metodat e mësimdhënies dhe standardet për përmbajtjen e mësimin. NJSBCZHK përbëhet nga 9 anëtarë dhe ka varësi nga Rektori i Universitetit. <i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2. Plan strategjik i zhvillimit i UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 18. Kalendar i takimeve të NJSBCZHK me Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 30. Plan i punës i NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i	Sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, siç janë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm. Ndër instrumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë përmendim monitorimet, anketimet, fokus grupet dhe bashkëpunimet me ekspertë të jashtëm. (përmendur më lart) UMSH ka marrë edhe

cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	mendimet e ekspertëve të jashtëm për përditësimin e kurrikulave dhe përshtatjen sa më të mirë të tyre me nevojat për kompetenca që ofron tregu i punës. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 18. Kalendar i takimeve të NJSBCZHK me Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti</i> <i>Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Treguesit e përdorur për matjen e mësimdhënies dhe aktiviteteve kërkimore janë të përcaktuar në një dokumentesh dhe rregulloresh të hartuara nga UMSH. Gjithashtu edhe Strategjia e zhvillimit të institucionit 2018-2023 ka të përcaktuar një seksion specifik për cilësinë. Universiteti ka ndërtuar procedura pune me lidhur me anektimet, fokus grupet dhe monitorimet. Tregues të veçantë matje kanë fokus grupet, anketimet dhe formularët e vlerësimit. Formularët e vetë vlerësimit të pedagogëve kanë disa karakteristika sasiore të tilla si: (i) Mësimdhënia në auditor; (ii) Veprimtari jashtë auditorit, në funksione të procesin mësimor; (iii) Kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese; (iv) Kontribut institucional në mbështetjen e njësive të UMSH; (v) Kontribut institucional në mbështetjen e administratës publike; (vi) Kontribut profesional zhvillim dhe transferim i teknologjive. Raportet e NJSBCZHK bëhen publike dhe ato i përcillen dekanatit si edhe diskutohen me njësitë respektive https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf <i>Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 46. Aneksi A Raporti i Vetëvlerësimit individual</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se UMSH harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave që ka ndërtuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raporti i hartuar nga NJSBCZHK që ka rezultatet e vlerësimeve dhe anketimeve dhe fokus grupeve përmbledhet dhe i drejtohet Rektoratit për të evidentuar si problematikat ashtu edhe shembujt pozitivë dhe për marrë vendime për ecurinë e mëtejshme. Informacionet/vlerësimet e përmbledhura përcillen si në nivel Rektorati edhe në nivel Departamenti ku zhvillohet programi i studimit. NJSBCZHK jep edhe rekomandime në rast kur gjen problematika. Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është në rang universiteti, pra e njëtrajtësuar për të gjithë institucionin. (ndryshimet qëndrojnë në objektivat e programeve të studimit apo shkallët krahasuese, por metodologjia dhe instrumentet e përdorura janë të njëjta.) <i>Evidenca 3. Rregullore e organizimit të UMSH</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Nga informacioni i përcjellë në formë dokumentare nga Institucioni si edhe nga diskutimi me NJSBCZHK edhe gjatë vizitës së GJVJ në institucion u evidentua se informacionet e mbledhura nga monitorimet tregojnë se aktiviteti mësimor është në përputhje me standardet e vendosura. Instrumentet e marra si të drejtpërdrejta, ashtu edhe pyetësorët apo fokus grupet me studentët kanë sjellë informacione që kanë vlerësuar ecurinë e procesit mësimor. Dokumentet e përcjellë përfshijnë edhe komunikimin me e-mail midis zyrave për transmetimin e informacionit të mbledhura nga NJSBCZHK. Baza e vlerësimit për stafin akademik është edhe vetëvlerësimi individual. Këtij vlerësimi, duke i shtuar edhe ato periodike të bëra nga NJSBCZHK përdoret në procesin e vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe përpara së firmosjes kontratës vjetore. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 46. Aneksi A Raporti i Vetëvlerësimit individual</i>

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që

UMSH për realizimin e vlerësimit të ecurisë dhe cilësisë së së programit të studimit përdor këto metoda të drejtpërdrejta:

1. Dëgjimi dhe vëzhgime në auditor. Këto bëhen për të gjithë pedagogët pa përjashtim dhe ato realizohen sipas një programi dhe kalendari vjetor. NJSBCZHK dhe një person tjetër nga njësia bazë dhe njësia kryesore kryejnë vlerësimin e mbarëvajtjes së orës mësimore. Edhe gjatë vizitës në institucion, në takim me pedagogët, GVJ u njoh me përdorimin e kësaj metode dhe informacionin që merret prej saj.
2. Vëzhgimet lidhur me respektimin e proceduarave të provimeve, monitorimin e korrigjimit të tyre, afatet e respektimin e formatit të provimeve.
3. Monitorimi i ndërtimit të syllabuseve dhe hartimit të tyre në përshtatje me udhëzimet dhe rregulloren e përcaktuar nga VKM.

Për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” praktika zhvillohet në auditor dhe është pjesë e monitorimit siç bëhet edhe për lëndët e tjera.

Ndër metodat e tjera që përdoren për vlerësim janë edhe:

- Sondazhet e studentëve
- Takimet me senatorët e Këshillit Studentor
- Fokus-Grupe

Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK

Evidenca 27. Procedura e punës me fokus grupet

Evidenca 28. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti

Evidenca 29. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues

Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK

Evidenca 32. Plani i monitorimit të DEKFK

Vlerësimi i programit të studimit realizohet në një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe duke përdorur edhe metodat e përshkruara më sipër.

Një tjetër mundësi për vlerësimin e programit akademik është edhe nëpërmjet Alumnit dhe ecurisë së tyre për punësim pas mbarimit të ciklit të plotë të studimit. UMSH organizon takime vjetore me Alumni duke marrë informacione dhe përvojat e tyre në ballafaqimin e njohurive me tregun e punës dhe pozicionet që ata kanë marrë pas diplomimit.

Evidenca 68. Formulari Alumni

<https://www.umsh.edu.al/c/98/alumni>

bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Konkluzione	Bazuar në informacionin e përcjellë dhe vizitës në institucion GVJ vlerëson se UMSH monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësité akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, UMSH ka ngritur NJSBCZHK, e cili ka në përbërjen e saj 9 individë të brendshëm. Në përbërje të këtij komisioni janë anëtarë përfaqësues nga të gjitha fakultetet, personal akademik dhe ndihmës akademik si edhe një përfaqësues i Këshillit Studentor. Anëtarët e këtij komisioni kanë një mandat 3-vjeçar. Kjo gjithë përfshirje bën që të sillen në NJSBCZHK përvoja nga të gjitha fakultetet si edhe këndvështrime të ndryshme, duke ndikuar kështu në monitorimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve. Si pjesë e procedurave të tij të punës, Njësia NJSBCZHK ka një rregullore të detajuar mbi bazën e të cilës funksionon, ku janë të përfshira edhe planifikimi i punës për monitorimin e cilësisë, mënyrën se si zhvillohen anketimet dhe përpunimi i tyre, kriteret për vlerësimin e stafit akademik. Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK Evidenca 32. Plani i monitorimit të DEKFK
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësité, individët,	NJSBCZHK, me 9 anëtarë të brendshëm, ka përfaqësues nga të gjitha fakultetet, personel akademik dhe ndihmës akademik si edhe një përfaqësues i Këshillit Studentor. Rregullorja organizimit dhe punës së NJSBCZHK është dokumenti bazë që përcaktojnë

studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	edhe proceduara, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të kësaj njësie. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve e programit të studimit.	Sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, sipas urdhrave administrativë mbi ngritjen jepet përbërja e këtij komisioni me pjesëmarrjen nga të gjithë anëtarët nga departamentet dhe fakultetet, nga Këshilli Studentor. Njësitë bazë dhe kryesore janë të përfshira nga çdo fakultet. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	NJSBCZHK siguron përfshirjen e anëtarëve të saj nga fakultete të ndryshme me një mandat 3-vjeçar. Po kështu edhe një student nga Këshilli studentor është pjesë e Njësisë. Respektimi i Rregullores së NJSBCZHK, Statutit dhe Rregullores së organizimit të brendshëm UMSH garanton respektimin e integritetit dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazi ndaj studentëve. <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ekspertët e jashtëm që UMSH afron për vlerësimin janë pedagogë dhe pjesëmarrës në projekte të mëparshme dhe që kanë ekspertizën e duhur për të procedurat, metodologjinë dhe mekanizmat për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe në RV të Brendshëm, siguri i cilësisë bazohet në disa rrathë të kontrollit dhe disa nivele si kontrolli nga drejtuesit e departamentit; NJSBCZHK, fokus grupet, pyetësorët/ anketimet. Sikurse u diskutua gjatë takimeve të GVJ në institucion, përfshirja e aktorëve të jashtëm në vlerësimin e cilësisë, për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” kryhet gjatë marrjes së eksperiencave si pjesë e ndërtimit apo rishikimit të kurrikulave, në përfshirjen e tyre si të

	ftuar për të ndarë më studentët përvojat e punës apo për t'i lidhur studentët më shumë me tregun e punës. <i>GVJ sugjeron që të institucionalizohet një aktor i jashtëm (pedagog i jashtëm, ekspert, etj.) si pjesë e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> Evidenca 4. Rregullore e organizimit të UMSH.pdf Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK			
Konkluzione	<i>Nga informacioni i përcjellë dhe i marrë gjatë vizivate në institucion, GVJ vlerëson se universiteti përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë si nga pikëpamja institucionale ashtu edhe për programin e studimit KMP. Gjithashtu informacioni nga vlerësimet bëhet transparent.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, Strategjitë, dhe baza rregullatore ku mbështetet aktiviteti i NJSBCZHK janë të miratuara dhe një pjesë e tyre, që lidhet me aktet e rëndësishme rregullatore janë edhe publike në faqen online të universitetit. Ndërkohë që NJSBCZHK harton kalendarin për aktivitetin e monitorimeve dhe vlerësimeve. Ky dokument diskutohet me drejtuesit e departamenteve dhe miratohet nga Rektori i Universitetit. Në ndërtimin e këtij kalendari dhe më pas zbatimin e tij është edhe një student që është anëtar i njësisë. Raportet e vlerësimit u njoftohen edhe drejtuesve të departamenteve përkatëse, dhe publikohen në nënfaqen online të dedikuar sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, në Raportin Vjetor të UMSH është e publikuar edhe puna e njësisë në faqen online të UMSH. Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK Evidenca 30. Plani i punës i NJSBCZHK https://www.umsh.edu.al/media/6613bc0628c21.pdf https://www.umsh.edu.al/d/155/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë	UMSH vlerëson çështjet e etikës dhe lirinë akademike si mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e mësimdhënies në universitet.

publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni, lidhur me të dhënat e detajuara për anketimet dhe programet e veçanta të studimit i konsideron sensitive të dhënat e monitorimit. Informacioni nga monitorimi ndjek hierarkinë e vendimmarrjes, duke u drejtuar tek drejtuesit, Rektori, Administratori, dekanët e fakulteteve. Raporti i detajuar i monitorimit dhe emrat specifike është pjesë e politikës së vlerësimit të performancës akademike, e cila realizohet në fund të çdo viti akademik nga eprorët respektivë. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mënyrat e përpunimit të informacioneve të mbledhura në forma të ndryshme në shërbim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Informacioni i mbledhur me të gjitha formatet (anketime, fokus-grupe, vëzhgime nga kolegët/drejtuesit e departamenteve, në orët e mësimi, etj.) përdoret nga njëra anë për të ndjekur ecurinë e situatës dhe gjithashtu për të sjellë në vëmendje problematika që duhet të marrin zgjidhje. Të dhënat nga pyetësorët vetëvlerësues shfrytëzohen edhe për të bërë krahasime në periudha kohore dhe për të bërë vlerësim të performancës. Rezultatet nga anketimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi në rastet kur është e nevojshme.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UMSH ka krijuar një bazën nënligjore mbi të cilën rregullohet monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë për të gjithë komponentët e saj. Kjo bazë rregullatore siguron që rezultatet e monitorimit të konsiderohen të rëndësishme për vijimësinë e punës dhe përmirësimin e cilësisë. Planet e punës dhe kalendari i aktiviteteve të NJSBCZHK sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin shumëplanësh të cilësisë në institucion. <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë	Për të realizuar përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në përmirësimin e cilësisë së programeve akademike UMSH përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Të drejtpërdrejta janë pjesëmarrja e pedagogëve dhe studentëve në organizmat që monitorojnë sigurimin e cilësisë. Informimi i studentëve realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në NJSBCZHK. Gjithashtu, informacion të rëndësishëm studentët marrin edhe në javën e parë të orientimit lidhur me ecurinë dhe mënyrat për të kontribuar në cilësinë e programeve të studimit.

të cilësisë së programit të studimit.	Në kalendarin e trajnimeve për 2022-2023 vihen re edhe aktivitetet që lidhen me rolin punën me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm për vlerësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. <i>Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 11. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 66. Programi i trajnimeve 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>Mbështetur në informacionin e përcjellë dhe të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht. UMSH ka politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit, të cilat janë publike, transparente.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” të ofruar nga “Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. **Përmbajtje bashkëkohore dhe literaturë e përditësuar:** Programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun” ofron përmbajtje bashkëkohore dhe mbështetet në literaturë të përditësuar, duke reflektuar standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.
2. **Staf i kualifikuar:** Personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në këtë program karakterizohet nga kualifikimet e larta, dedikimi dhe përgjegjshmëria në punë, duke përfshirë pedagogë me përvojë të spikatur akademike dhe profesionale.
3. **Infrastrukturë e përshtatshme:** Ambientet moderne dhe funksionale, të pajisura me bazë materiale të mjaftueshme, sigurojnë kushte optimale për realizimin e detyrimeve mësimore dhe veprimtarive shkencore.
4. **Mbështetje financiare dhe tarifa të përballueshme:** Politikat e tarifave dhe mbështetja financiare u mundësojnë qasje në arsim studentëve nga shtresat në nevojë, ata të marginalizuar dhe studentëve ekselentë.
5. **Strategji dhe procedura të qarta zhvillimi:** Programi bazohet në një strategji të qartë zhvillimi, duke harmonizuar objektivat e institucionit dhe duke përfshirë procedura të konsoliduara për përditësimin e plan-programeve dhe metodave didaktike.
6. **Marrëveshje bashkëpunimi dhe mbështetje praktike:** Marrëveshjet me institucione publike dhe private, si dhe me media dhe ente profesionale, kontribuojnë në azhurnimin e stafit dhe në përmirësimin e mësimdhënies, duke mbështetur studentët në përgatitjen për tregun e punës.

Pika të dobta:

1. **Numri në rënie i studentëve në këtë program studimi.** Nga viti në vit vihet re një rënie e numrit të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi, gjë që rrezikon të ardhmen e tij. (Standardi V.4,Kriteri 1)
2. **Mungesa e vijimësisë në ciklin Master për program studimi me fokus në komunikim dhe marrëdhënie publike.** Do të ishte me racionale dhe me tërheqëse për studentët që ndjekin këtë program studimi që të vijojnë studimet e ciklit të dytë në të njëjtën fushë. (Standardi II.4,Kriteri 7)




Rekomandime:

1. Zhvillimi i një fushate më intensive në promovimin e programit të studimit për të thithur më shumë studentë që të regjistrohen në program. Afrimi edhe i studentëve nga trevat shqipfolëse jashtë kufijve të Shqipërisë.
2. Përditësimi i udhëzimit për mësimdhënien online mund të zgjerohet duke përfshirë edhe udhëzime mbi metodat alternative të mësimdhënies. (Kriteri VI. Standardi VI. 1.1).
3. Ndonëse brenda institucionit ka një praktikë të lavdërueshme në lidhje me marrjen e opinionit nga aktorë të jashtëm në kuadër të sigurimit të cilësisë, sugjerojmë që një ekspert i jashtëm, (pedagog i jashtëm, ekspert, etj.) të angazhohet si pjesë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. (Kriteri VI. Standardi VI. 4.5)

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Communication and Public Relations" offered by "Mediterranean University of Albania"

Strengths and affirmations:

1. Contemporary content and updated literature: The Bachelor's study program in Communication and Public Relations offers contemporary content and is based on updated literature, reflecting academic standards and labor market requirements.
2. Qualified staff: The academic and support staff engaged in this program are characterized by high qualifications, dedication and responsibility at work, including lecturers with outstanding academic and professional experience.
3. Appropriate infrastructure: Modern and functional environments, equipped with sufficient material base, provide optimal conditions for the realization of teaching obligations and scientific activities.
4. Financial support and affordable fees: Fee policies and financial support enable access to education for students from disadvantaged backgrounds, the marginalized, and excellent students.
5. Clear development strategies and procedures: The program is based on a clear development strategy, harmonizing the objectives of the institution and including consolidated procedures for updating curricula and teaching methods.



6. Cooperation agreements and practical support: Agreements with public and private institutions, as well as with media and professional bodies, contribute to the updating of staff and the improvement of teaching, supporting students in preparing for the labor market.

Weaknesses:

1. Declining number of students in this study program. From year to year, a decrease in the number of students who have followed this study program is observed, which jeopardizes its future. (Standard V.4,Criterion 1)

2. Lack of continuity in the Master's cycle for a study program with a focus on communication and public relations. It would be more rational and attractive for students who follow this study program to continue their second cycle studies in the same field. (Standard II.4,Criterion 7)

Recommendations:

1. Develop a more intensive campaign to promote the study program to attract more students to enroll in the program. Reach out to students from Albanian-speaking regions outside the borders of Albania.

2. Updating the online teaching guidelines could be expanded to include guidelines on alternative teaching methods. (Criterion VI. Standard VI. 1.1).

3. Although there is a commendable practice within the institution regarding obtaining opinions from external actors within the framework of quality assurance, we suggest that an external expert (external lecturer, expert, etc.) be engaged as part of internal quality assurance. (Criterion VI. Standard VI. 4.5)


Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized loop followed by a series of vertical strokes and a long horizontal tail.

